

NENDORI

REVISTË E PËRNUAJSHME
LETRARE — ARTISTIKE
SHOQËRORE — POLITIKE
(Viti II. i botimit)
Nr. 3 — Mars 1955

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE TË SHQIPËRISË
DHE I LIDHJES SË ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

LËNDA

	Faqe
ANDREA VARFI	Për paqen po firmojmë, <i>vjershë</i> 3
LLAZAR SILIQI	Që t'i këndosh pranverës, <i>vjershë</i> 4
ROBERT SHVARC	Nëna, <i>vjershë</i> 7
A. BANUSHI	Bisedim me motrën franceze, <i>vjershë</i> 8
SPIRO XHAI	Amaneti i gjyshit, <i>tregim</i> 10
VEIS SEJKO	Ngjarje të zakonshme, <i>tregim</i> 20
VANGJEL FOTI	Mir' se të urdhëroni, <i>vjershë</i> 38
BEKIM GAÇEJ	Në breg të Drinit — E dua këtë rrugë... — Mori djali të përcjellë ... — Dritarja ha- pur po qëndron, <i>vjershë</i> 39
VELI ISLAMI	Mira — Zana, <i>vjersha</i> 41
HYJNI CEKA	Lekua i Telo Rapit, <i>tregim</i> 42
MIHAL MAÇKO	Ç'i ngjau Vaso Nikollanit, <i>tregim</i> 51
SHAQIR PRİZRENDI	Agimi i ri, <i>vjershë</i> 56
SKËNDER ARRËZA	Lëndina e loteve — Vajza nga Vladivosto- ku, <i>vjersha</i> 56
NAUM PRIFTI	Zenel Dauti, <i>tregim</i> 58

400 VJETORI I "MESHARIT" TË GJON BUZUKUT

MAHIR DOMI	Libri i parë shqip dhe fillimet e letërsisë shqipe 63
EQREM QABEJ	Gjon Buzuku dhe gjuha e tij 70
JUSTIN RROTA	Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut 76

PLENUMI I LIDHJES SË ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

FOTO STAMO	Zhvillimi i arteve figurative 80
DHORA LEKA	Krijimtaria muzikore 95
BAKI KONGOLI	Aktiviteti i Lidhjes së Artistëve prej krijimit deri më sot 115

KRITIKË LETRARE DHE ARTISTIKE

ZIAUDIN KODRA	Këngët e Milosaos 120
NASHO JORGAQI	Hapi i parë 124
STERJO SPASSE	"Përrallëza dhe Gjëza" nga Vehbi Bala 127
OLLGA QANO	Mbi librin përfëmijë «Miçja» 129
XHEMAL BROJA	Mbi çfaqjen e dramit «Dasma e madhe» 131

PUBLICISTIKË

SOTIR PAPULI . . .	Vazhduesi i madh i çështjes së Leninit	135
QEVTQEP KAMBO . . .	Frederik Zholio Kyri	140
SELMAN VAQARI . . .	Artisti i madh shqiptar Aleksandër Moisiu	147

KRITIKË SOVJETIKE

P. TROFIMOV, J. BO- REV, V. VANSLLAV. V. SKATERSHÇIKOV .	Parimet e estetikës marksiste-leniniste	160
--	---	-----

KRONIKË KULTURALE

Sesion shkencor kushtuar 400 vjetorit të "Mesharit" — të Gjon Buzukut — Plenumi i Lidhjes së Artistëve — Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm arsimor të Ministrisë së Arësimit e Kulturës mbi mësimin e gjuhës në shkollat tona. — Seminar me letrarët e rinj — Takime me spektatorët — Nga aktiviteti i Kinostudios përmuanin shkurt — Deklaratë e Sekretariatit të Presidiumit të Bashkimit të Shkrimitarëve të Bashkimit Sovjetik — Në Teatrin Bolshoi u çfaq koncerti i fundit i festivalit të pestë kombëtar të grupeve artistike diletante të rezervave të punës — Në Leningrad organizohen ekspozita kushtuar 350 vjetorit të botimit të parë të "Don Kishotit" — Përkujtohet dy qind vjetori i vdekjes së filozofit të madh francez Moteskjë — Po përgatitet një edicion në gjuhën ruse i veprave të Rabindranath Tagore — Një shprehje e forcimit të marëdhënjeve miqësore dhe kulturale midis popujve gjerman dhe sovjetik — Në Çeljabinsk u hap një teatër i ri i operes dhe baletit — Ukraina ka 137 institute të larta — Zbulohen dokumenta të çmueshme mbi jetën dhe veprat e poetit të madh polonez Adam Mickiewiç — Artistët kinezë çfaqën një opër klasike koreane — Në Varshavë u dha një koncert me rastin e inaugurimit të konkursit të pestë ndërkombëtar Shopen — Mbledhje solemne në Sofje kushtuar 200 vjetorit të vdekjes së filozofit të madh francez Monteskjë — Jeta kulturale në fshatin çekoslovak — Shtimi i botimit të veprave letrare në Hungari — Në Rumani protestohet kundra krimit fashist të bërë kundra Legatës së R. P. të Rumanisë në Bernë — Për bashkimin e Gjermanisë në mënyrë paqësore — Suksese të arësimit populor në R. P. të Mongolisë — Lufta për zhvillimin e kulturës është njëkohësisht lufta për paqen.	175
---	-----

«KULTURA» NË BOTËN KAPITALISTE

196

ANDREA VARFI

Për paqen po firmojmë

Salla buqet në brohorë për paqen:
Shqipëtarë e Shqipëtarka po firmojnë!
Me ne firmojnë sot të gjithë popujt, —
të sigurt ne të ardhmen e shikojmë!

Me radhë u ngritën dhe po hedhin firmat sulmorjës, vajza e djema, sytë-flakë...
Pastaj tribunës po i afërohet
dhe nis të flasë dalngadal një plakë:

— Më paqën je, apo me luftën, nëno?
më tha dje ime-mbesë, e vogla Flutur.
— Po c'është paqa, shpirt? — e pyes unë.
— Paqa, moj nënë, është pëllumb i bukur! —

Më tutje nuk e zgjata, po e putha.
Dy lot pa pritur mua më rrëshqitën
— Me paqen jam, o Flutur — iu përgjegja —
— Njeri nuk është ai që s'e do dritën! —

— Dy djem, o bij e bija jaradisa;
të dy skyfterë mali, po m'u vranë;
njeri në luftë, tjetri me spiunët
dhe vetëm këtë mbesë ata më lanë.

I ziu burrë, atje në Mal të Çikës
në mes të borës, kur do myllte sytë,
më tha: — O grua, s'ikij zemërplasur,
i le Shqiprisë djemtë, dy astritë! —

Më dhëmb në xhan që djemtë s'i kam gjallë,
se nënë jam, i rrita me thërrime,
po kur shikoj se kam ju bij e bija,
më ngrohet shpirti e bëhem dhe më trime.

Seç pashë e hoqa nuk i zë me gojë,
si unë gjithë nënët panë e hoqën...
Tashti po fluturon pëllumbi ynë
nuk lem' t'ia djegin krahët, si ia dogjën.

FOTO STAMO

Zhvillimi i arteve figurative *)

Revolucioni ynë Popullor i solli popullit shqiptar një fitore të shkëquer, i solli pushtetin popullor dhe nënë këtë pushtet populli ynë gjatë 10 vjetëve të cilirit të tij ka korru suksese në ndërtimin ekonomik dhe kultural, suksese që nuk i ka parë asnje herë në historinë e tij.

Fill pas cilirimit të vëndit Partija dhe Qeverija e jonë i dhanë një rëndësi të veçantë zhvillimit dhe përparimit të gjithanshëm të vëndit, këshfu kultura, shkenca, letërsija dhe artet zonë një vënd të rëndësishëm në gjithë aktivitetin shtetëror. Eshtë krejt e natyrëshme dhe karakteristikë e pushtetit popullor që të flaki përtëj errësirën dhe prapambetjen e shekujve që rëndonte mbi shpatullat e popullit tonë, të shkaktuar nga regjimet feudalo-borgjeze të vëndit dhe nga imperialistët e huaj.

Brenda një kohe të shkurtër populli ynë nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të Qeverisë së tij dhe me ndihmën e pa kursyer të Bashkimit Sovjetik dhe të Demokratike Popullore, ka korru suksese të mbëdhëna në sektorin e kulturës, në lëmin e shkencave, të letërsisë dhe të arteve dhe bilanç i bërë për 10 vjetorin e cilirimit është një provë konkrete e këtij përparimi.

Gjatë këtyre 10 vjetëve populli ynë i udhëhequr nga Partija e tij e Punës dhe Qeverija e tij është mobolizuar i téri për ndërtimin e socializmit në vëndin tonë, ai me punën e tij paqësore ka arritur suksese të rëndësishme dhe sëbashku me popujt e tjerë përparimtarë të botës, me në krye popujt e Bashkimit Sovjetik ngre zérin për mbrojtjen e lirive dhe të indipendencës së popujve që kërcënohen nga imperialistët amerikanë dhe englezë, të cilët kërkojnë të shpërthejnë një luftë të tretë botërore.

Populli ynë është solidarizuar me vendimet e Këshillit Botëror të Paqës, të cilat ftojnë popujt e gjithë botës të shtojnë përpjekjet e tyre kundër shpërthimit të luftës dhe kundër përdorimit të armëve të çfarosjes në masë, të armëve atomike. Punonjësit e artit të vëndit tonë, sëbashku me popullin kanë ngritur zérin e tyre kundër luftënxitësve imperialistë dhe planeve të tyre agresive. Ne duhet të vëmë të gjitha forcat tona krijonjëse që vepra e artit t'i shërbejë mirëqënies, t'i shërbejë vëllazërimi dhe mbrojtjes së paqës. Veprat e artit të demaskojnë pa mëshirë qëllimet e luftë-nxitësve dhe agresorëve imperialistë. Sa më me përbajtje të shëndoshë të jetë vepra e artit, aqë më aktive dhe aqë më e dobishme do të jetë në shërbimin e saj për popullin dhe mirëqënien e tij, për paqën. Unë ju ftoj shokë punonjës të arteve figurative, të solidarizohemi edhe ne plotësisht me vendimet e Këshillit Botëror të Paqës, që u muarnë tanë sëfundi në Vjenë dhe të ngremë zérin kundër

*) Referat i mbajtur në mbledhjen plenare të punonjësve të arteve figurative

vendimeve të Parisit dhe të Londrës që synojnë në krijimin e Vermahit gjerman, kundër përdorimit të armëve atomike dhe të bëjmë që energjia atomike të përdoret për qëllime paqësore ashtu siç e përdori për të parën herë Bashkimi Sovjetik në ngritjen e të parit central elektrik që funksionon me energji atomike.

Gjatë këtyre 10 vjetëve në lëmin e arteve figurative janë bërë përparime të dukeshme dhe ato me aktivitetin e tyre zënë një vënd me rëndësi në gjithë aktivitetin artistik të Republikës. Sukseset e arritura në fushën e arteve i dedikohen pushtetit popullor, sepse, krijoi mundësitë e zhvillimit të pakufizuar të të gjitha gjinive artistike dhe sot vendi i ynë ka një aktivitet artistik të gjithanëshëm që nuk e ka patur asnjerë. Siç janë krijuar kondita për artet e tjera, gjithashtu janë krijuar kondita edhe për zhvillimin e arteve figurative. Eshtë çmuar rëndësia e arteve figurative, e piktorës, skulpturës, karikaturës dhe pllakatit si mjete edukative, sepse nëpërmjet veprave të artit rritet niveli kultural i masave.

Sot, punonjësit e artit sëbashku me ta edhe punonjësit e arteve figurative kanë vëndin e tyre, ata nderohen dhe puna e tyre çmohet nga Pushteti dhe nga vetë populli për misionin e tyre të lartë. Sot, punonjës të çquar të artit, letrarë, këngëtorë, kompozitorë janë përfaqësues të popullit në Kuvendin popullor. Për veprimtarinë krijonjëse janë vënë çmimi për të shpërblyer krijimtarinë e punonjësve të artit, siç është çmimi më i lartë i shtetit: «Çmimi i Republikës». Këto çmime i gjëzojnë sot edhe punonjës të arteve figurative si shokët Nexhmedin Zajmi, dhe Lazar Nikolla. Nderi që u bëhet sot punonjësve të arteve nga Partia, Pushteti dhe nga masat punonjëse, ata nuk e kanë gjuar kurrrë në të kaluarën.

Gjatë 10 vjetëve, artet figurative janë zhvilluar më tej dhe këtë zhvillim e ka favorizuar ndihma dhe kujdesi atëror që ka treguar Partia dhe Pushteti Popullor. Zhvillimin e arteve figurative e kanë ndihmuar udhëzimet e çmuara të Partisë; këto kanë ndihmuar që punonjësit e arteve figurative të rritin njohuritë e tyre ideologjike dhe politike, duke kryer këshfu vepra më të plota si nga forma ashtu dhe nga përbajtja. Për këtë zhvillim të mëtejshëm të arteve flasin edhe vendimet e Partisë, në të cilat thuhet: ...letërsija, muzika dhe artet figurative duke zbatuar metodën e realizmit socialist kanë filluar të ecin në rrugën e Partisë. Cilësia ideo-artistike e veprave letrare dhe artistike vë në jetë fjalët e J.V. Stalinit «që kultura nationale duhet të jetë socialiste nga mbrendija dhe nacionalë nga forma». Letërsija, artet, dhe muzika janë rritur shumë nga piktorët e sasisë. Gjinitë e ndryshme kanë filluar të zhvillohen në mënyrë të kënaqëshme. Letërsija dhe artet kanë filluar të jepin kontributin e tyre në edukimin socialist të masave të punonjësve të vëndit tonë».

Ky paragraf tregon se artet në përgjithësi si edhe artet figurative, mbredha një kohe të shkurtër kanë bërë përparime të dukshme.

Për zhvillimin e arteve figurative ndihma e shtetit ka qënë e gatshme, sepse shteti ka investuar fonde të veçanta për të kryer punime të ndryshme në sektorin e piktorës dhe skulpturës. Janë ngritur buste dhe monumente në qytete të ndryshme të vëndit. Këto punime u janë kushtuar njerëzve të çquar, heronjve të Luftës Nacional Clirimtare: Qemal Stafa, Vojo Kushi, Ali Kelmendi, etj. Punime kushtuar udhëheqësve të çquar të proletariatit botëror: V.I.Lenin dhe J.V. Stalinit. Një rëndësi të veçantë zë ngritja e Galerisë së Arteve Figurative, e cila ngrihet për

të parën herë dhe përfshin në gjirin e saj punimet më të mira të piktorëve dhe skulptorëve tanë. Ajo sot është bërë nië oëndër artistike dhe kulturale, sense vizitohet shprehja nga masat punoniëse. Një kuidas i vecantë është treguar për krijuimin e kuadrove në fushën e arteve figurative, Liceu Artistik «Jordan Misia» ka nxjerrë kuadro të rini me kulturë artistike të mesme, të cilët shërbejnë në sektorë të ndryshëm, janë dërguar jashtë Shtetit në Bashkimin Sovietik dhe në Demokracitë Popullore nxënës të dalluar dhe me talent. Këto kuadro të reja, që kanë filluar të vinë, kanë shtuar radhët e punonjësve të arteve figurative dhe janë një forcë e re krijonjëse, e cila do t'i shërbejë me siguri zhvillimit të mëtejshëm të arteve figurative.

Arjet figurative brenda 10 vjetëve, në të gjitha gjinitë, ku më pak e ku më shumë, kanë kaluar fazën e tvre të parë dhe kanë bërë nënramime dhe aktivi i arteve figurative është pasuruar me vepra, të cilat kanë vlerën e tyre ideologjike dhe artistike. Cilësija e veprave të artit në pikture dhe skulpturë na tregon gjithashut aftësitë krijonjëse të punonjësve të arteve figurative, të cilët kanë bërë përparime në ngritjen ideologjike dhe profesionale të tyre.

Aktiviteti i arteve figurative nuk është sot një aktivitet spontan, por është një aktivitet i rregullt artistik, i cili ka vënë arjet figurative në një pozitë të re të zhvillimit të tyre. Këtë e kanë treguar ekspositat e ndryshme dhe punimet në sektorin e piktures dhe skulpturës, të plakatit dhe të karikaturës që janë bërë gjatë 10 vjetëve.

Duke filluar nga viti 1945, fill pas çlirimtari të Shqipërisë janë çelur me radhë eksposita të arteve figurative, në të cilat është paraqitur krijimtaria e punonjësve të arteve figurative. Këto eksposita na kanë treguar se puna krijonjëse e piktorëve dhe skulptorëve është rritur nga viti në vit dhe se në ekspositizen e vitit 1952 u paraqiten punime më të mira me një lartësi krijonjëse dhe pat prej tyre që merituan Çmimin e Republikës. Një përparim i dukshëm konstatohet gjithashut në ekspositizen që u inauguroua në muajin Nëndor të vitit të kaluar. Gjatë këtyre 10 vjetëve në aktivitetin e arteve figurative konstatohen edhe të meta, të cilat e kanë penguar krijimtarinë artistike të ecë përpara më shpejt në zhvillimin e saj, por këto të meta kanë ardhur gradualisht duke u përmirësuar. Në punimet artistike të arteve figurative ne shohim se pasqyrohet vetëm një anë, ana pozitive. Kjo është një anë me shumë rëndësi sepse ana pozitive i shërben ecjes përpara të shoqërisë sonë. Në punimet paraqiten stahanovistë, fragmente historike nga Lufta N. çl. dëshmorë, heronj, fragmente nga ndërtimi paqësor i vëndit, dhe natyrren e bukur t'atdheut tonë, të cilat meritojnë plotësisht të vihen në dukje me anën e krijimtarisë artistike. Por ne duhet të kalojmë në krijimtari duke treguar edhe anë negative me episode të ndryshme përtë treguar dhe dënuar veset e sëmura dhe të metat që manifestohen në jetë dhe në ndërgjegjen e njerëzve si mbeturina të jetës feudale dhe borgieze. Duke e paraqitur edhe këtë anë, vepra e artit ndihmon në zhvillimin e krijimtarisë artistike dhe në edukimin e njerëzve përtë të lëftuar të metat dhe veset e sëmura.

Materialet e Kongresit të XIX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik thonë: «Forca dhe rëndësia e artit realist socialist është se ay mund dhe duhet të nxjerrë në shesh dhe të zbulojë cilësitet e larta shpirtërore dhe veçantë pozitive tipike të karakterit të njeriut të thjeshtë, tipin e tij të qartë artistik përtë qënë shëmbull dhe objekt mësimi përtë njerëzit». Pikerisht ne duhet t'i kupëtожmë mirë këto çesh-

tje dhe t'i zbatojmë këto në veprën artistike. Zbulimi i cilësive shpirtërore, konkretizimi i tyre në shprehjen e veçantë të personazheve, të fizionomisë së tyre e bën personazhin të tregojë botën e mbrendëshme të tij dhe sa më mirë të jetë arritur dhe shprehur cilësija shpirtërore nga ana e artistit, aqë më vlerë merr personazhi dhe aqë më artistike paraqitet vepra e artit. Ne nuk insistojmë ashtu siç duhet në ndërtimin e fizionomisë, në shprehjen e personazheve, prandaj ato nuk janë akoma të plota në paraqitjen e tyre dhe në këtë drejtim dalin të zbehta cilësitet shpirtërore dhe veçantë pozitive tipike të karakterit të njeriut të thjeshtë, prandaj mendojmë se artistit duhet t'i tërheqë vemendjen ndërtimi i plotë i figurave, i personazheve që ka zgjedhur si protagonistë të veprës së tij.

Materialet e Kongresit për këtë çështje thonë: «Në veprat e tyre shkrimitarët dhe njerëzit tonë të artit, duhet të goditin të metat, gabimet, gjërat e sëmura që janë të përhapura në shoqëri, të krijojnë figura artistike pozitive të njerëzve të tipit të ri, ku të zbulohen në të gjithë madhështinë meritat e tyre njerëzore dhe njëkohësisht të ndihmojnë në edukimin e njerëzve të shoqërisë sonë me karaktere dhe zakone të lira nga plagët dhe të metat e lindura nga kapitalizmi».

Veprimtarija krijonjëse e arteve figurative e derisotëshme, nuk ka akoma ndonjë rast ku të tregohet me tërë forcën pasqyrimi i konfliktit dhe i kontradiktave në veprën e artit dhe kjo çështje me rëndësi artistike dhe ideologjike, lidhet ngushtë në radhë të parë me aftësitë krijonjëse dhe ideologjike të punonjësve të arteve figurative. Ne nuk kemi ndonjë vepër arti akoma, ku të tregohet me të gjithë madhështinë e saj qëndrimi i puntorëve shqiptarë përpara givqeve fashistë ose qëndrimi heroik i të rinjve në torturat e organizuar nga fashistët, ose në përlleshje me armë në demonstratat kundër okupatorëve fashistë siç paraqitet vepra e Piktoret Sovjetik Jogancion me temë nga «Lufta e bolshvikëve rusë përtë Revolucionin e Math Socialist të Teterit». Jogancioni paraqet në veprën e tij një punëtor dhe një punëtore komuniste, të cilët gjykohen. Komunistët qëndrojnë të patriëmbur dhe krenarë. Dhe n'anën tjetër piktori ka paraqitur oficerët armiq që gjykojnë dhe që janë egërsuar nga qëndrimi i komunistëve. Një vepër e tillë, është realizuar miaft mirë dhe na tregon me të vërtetë një konflikt politik.

Një çështje e tillë, një ndërtim artistik me një temë të tillë, tregon dhe pasqyron konfliktin dhe e vë veprën e artit në një shkallë më të lartë. Kjo situatë na tregon se punonjësit e arteve figurative të vëndit tonë, nuk janë hedhur akoma në një gërshtetim të tillë dramatik në veprën e artit. Por duhet theksuar se në këtë drejtim kemi një fillim sado i vogël që është.

Një problem i tillë siç është çështja e konfliktit në veprën e artit, duhet të na tërheqë vëmëndjen tonë dhe punonjësit e arteve figurative duhet të mendojnë më gjerë dhe të pregatiten më mirë përtë zgjedhjen e veprimtarisë artistike në çdo lloj arti, duke na kujtuar të shikojnë më thellë fenomenet dhe ngjarjet në shoqëri, si dhe zhvillimin e tyre dhe këto të pasqyrohen me anën e krijimtarisë artistike të plotë.

Në ekspositat e viteve të kaluara janë paraqitur punime, të cilat nuk kanë patur një të vërtetë konkrete ngajeta e përditëshme, por janë kapur gjëra të përgjithëshme, përshtypje, ku figura e njeriut, e cila është gjëja kryesore ka munguar duke e lënë atë në një plan të dytë e të tretë dhe duke e zënë vëndin e parë peisazhi. Një veprim i tillë në krijimtarisë artistike nuk është i drejtë se konfondon objektet e planit të parë nga

ato më të rëndësishmet me planet e dytë dhe të tretë, sepse njeriu dhe jo çdo njeri, duhet të vendoset mirë, të trajtohet artistikisht dhe të vendoset në vendin që meriton. Përsa i përket peisazhit dhe objekteve të tjera, të gjitha këto do të vendosen dhe do të trajtohen sipas rëndësise së tyre.

Vëprimtarja artistike e arteve figurative, na tregon gjithashtu se akoma nuk është trajtuar siç duhet heroi pozitiv, sepse figura qëndrore nuk janë trajtuar me fërë forcën e tyre. Kjo cështie ka akoma të meta sidomos më trajtimin definitiv të portreteve. Heroi pozitiv duhet të jetë figura më simpatike, jo një figurë ideale, por një figurë reale, e thjeshtë. Figura e personazhit është ndodhet në gjirin e masave. Këtë figurë duhet t'a kërkojë artisti lidhur me temën që trajton ay.

Duke parë rrethanat e rrities dhe zhvillimit të arteve figurative, duke i lidhur këto me të kaluarën e tyre, ne mund të themi, se në lëmin e arteve figurative ka një rritje të konsiderueshme të punës krijuarës së dhe kjo lidhet me përparimet artistike, me formën dhe përbajtien e veprave të artit. Këtë na e tregoi ekspozita e viti 1952 dhe ekspozita që u inagurua më 26 Nëendor të viti 1954 për ndër të 10 vjetorit të cilirit.

Në ekspozitën dhe në konkursin e arteve figurative, u paraqitën afro-70 punime piktore, skulpture, karikature dhe pllakati. Pjesëmarria e plakatit dhe karikaturës na tregon se aktiviteti i arteve figurative është shtrirë edhe në dy gjini të tjera, n'atë të pllakatit dhe të karikaturës, pamvarësish nga zhvillimi i tyre dhe nga sasia e punimeve që u paraqitën mund të themi se është një hap i mirë për zhvillimin e këtyre dy gjinive me mjaft rëndësi. Kjo cështie vlen të theksohet sepse në asnjë nga ekspozitat e viteve të kaluara nuk janë paraqitur punime të këtyre dy gjinive dhe punime si këto që merituan të vlerësohen nga konkursi.

C'na tregoi konkursi dhe ekspozita:

Konkursi dhe ekspozita vjetore e arteve figurative na tregoi se punonjësit e arteve figurative mobilizuan forcat e tyre krijuarës për t'u paraqitur sa më mirë në konkurs dhe në ekspozitën vjetore dhe mund të themi se në përgjithësi veprat e pikturës, skulpturës, karikaturës dhe pllakatit, na jepin të kuptojmë se gjatë këtyre dy vjetëve të fundit në sektorin e arteve figurative kemi rezultate të kënaqëshme. Ne shohim se piktoret dhe skulptoret janë hedhur me guxim në punime të stilit të gjësë siç është kompozicioni që kërkon një preqatitje të gjithanëshme profesionale. Ne shohim sot punime me tema të gjëra ku dominon më shumë figura e njeriut. Kjo anë në vëprimtarinë e arteve figurative është një hap përparrë.

Eksperiencia e punës na tregon se më përparrë në punimet e pikturës sundonte më shumë peisazhi, portreti dhe natyra e qetë, domethënë një krijimtar e ngushtë e artit. Një cështie e tillë u është ngritur disa herë me radhë punonjësve të arteve figurative dhe ekspozita e viti 1952 shënoi një hap përparrë përsa i përket zgjerimit të tematikës në sektorët e ndryshëm të jetës sonë, gjithashtu mendojmë se ekspozita e viti 1954 dha rezultate të mira në këtë drejtim sepse tematika është më e zgjeruar, e ndryshme dhe kompozicioni përfshin një numur më të madh piktoretë skulptoretë dhe punimet paraqiten në një lartësi artistike të konsiderueshme. Prandai në këtë fakt meriton të thuhet se punonjësit e arteve figurative kanë bërë një ndryshim në punën e tyre krijuarës, d.m.th. një zhvillim të mëtejshëm, janë lidhur më ngushtë me profesionin e tyre në krahësim me të dieshmen, kur në përgjithësi kryenin funksionin e një mësuesi të thjeshtë në shkollat filllore dhe të mesme.

Në përfundimin e një pune artistike të tillë, kanë influencuar disa faktorë. Ka influencuar orientimi i Partisë për artet figurative, kujdesi që tregohet për 'to, eksperiencia e artit sovjetik dhe e punonjësve të artit sovjetik.

Punimet e paraqitura në ekspozitë dhe në konkurs, na tregojnë se piktorët, skulptorët, pllakatistët dhe karikaturistët janë frymëzuar nga fitoret e Luftës nacional - çlirimtare dhe nga puna paqësore për ndërtimin e bazave të socializmit. Mbi këtë tematikë u paraqitën punimet në konkurs dhe në ekspozitë. Ja një pasqyrë e disa punimeve: busti i Dëshmorit Mihal Duri nga skulptori Lazar Nikolla, tablloja «Prita Partizane» e piktorit Nexhmedin Zajmi, «Trim i Nanës» e piktorit Angjelin Dod Masei, «Tre Heronjtë» e piktorit Vlladimir Jani, «Kthimi» nga piktori Sali Shijaku, «Kalimi i Divisionit të Parë në Veri» nga Sadik Kaceli, «Lufta e Mushqetës» nga piktori Kel Kodheli.

Në temën nga ndërtimi paqësor i vëndit u paraqitën piktorët dhe skulptorët: piktori Abdullah Emin me tablonë «Zotër të Tokës», Odhise Paskali me grupin «Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë», Vangjush Mio me tabllotë «Peisazh Vjeshte» dhe «Vjelja e paxhar sheqerit», Bukurosh Sejdini me tablonë «Vjelja e Pambukut», Lazar Nikolla me grupin skulptural «Muratorët», si dhe punime të tjera të artistëve Janaq Paço, Dhimitër Çani dhe skulptorëve të rinj Thoma Thomai, Sami Turku, Dhimitër Buda, Llukan Bushi.

Nga kjo paraqitje ne kuptojmë se punonjësit e arteve figurative, kanë kuptuar rëndësinë që ka zgjedhja e subjektit, tematika dhe ne shohim se nuk kemi të bëjmë me zgjedhjen e një portreti, të një peisazhi të thjeshtë, të një peme sidokudo, por kemi të bëjmë me subjekte të rëndësishme qoftë nga funksioni i tyre, qoftë nga rëndësija e tyre shoqërore dhe historike, dhe se piktorët e skulptoret kujdesen njëlloj si për trajtimin artistik të veprave të tyre, për gjetjen e subjektit ashtu dhe për trajtimin ideologjik të veprave.

Duke marrë parasysh në vijë të përgjithëshme punimet e paraqitura në konkurs dhe në ekspozitë, mund të dallojmë lehtë se në të sundon më tepër subjekti historik me temë të Luftës nacional - çlirimtare. Kjo tregon se është anuar më shumë nga episodet e Luftës nacional çlirimtare dhe më pak nga tema aktuale dhe ndërtimi paqësor i vëndit. Kjo cështje nuk e dëmton krijimtarinë, por në punimet mungojnë episode me tema nga punonjës të industriës, nga punonjës të bujqësisë, minatorë, etj. Gjithashtu vihet re mungesa e portretit heroik me të cilin mund të paraqiten fare mirë punonjës të çquar të vëndit si stahanovistë, racionalizatorë dhe heronj të punës socialiste. Duke e parë këtë cështje lidhur me krijimtarinë, punonjësit e artit është mirë të kenë parasysh zgjedhjen e tematikës që të përfshijë sektorë të ndryshëm, sepse një paraqitje e ndryshme në ekspozitën vjetore, bëhet akoma më interesante dhe njëkohësisht punonjësit e arteve figurative, paraqitin me aktivitetin e tyre jetën e gjithanëshme të vëndit. Kjo pasqyron krijimtarinë e arteve figurative dhe veprën e artit e bën të lozë një rol më aktiv dhe edukativ në misionin e saj.

Punonjësit e arteve figurative duhet të kujdesen më shumë për të zgjedhur tematikën e veprave të tyre, sepse do të evitohet rasti i njëanëshmërisë së tematikës. Tematika në artet figurative duhet të përshkohet momente dhe ngjarje të jetës së gjithë popullit tonë; të lidhet me patriotizmin e popullit tonë, me të kaluarën historike të tij, me rezultatet e shkëlqyera dhe të realizimeve të punës së tij. Një tematikë e tillë jo

vetëm që do t'a bëjë veprën e artit një mjet edukonjës dhe të fuqishëm, por do ta ngrerë në të njëjtën kohë rolin e artit dhe të veprës së artit. Në këtë drejtim artet figurative forcojnë përbajtjen dhe formën e tyre dhe futen kështu në rrugën e artit të realizimit socialist.

Ne konstatojmë nga puna krijonjëse e arteve figurative se punonjësit e arteve kanë kërkuar një botkuptim të ri mbi mjeshtérinë e artit, mbi subjektin, trajtimin dhe përbajtjen e veprave të artit, kundër botkuptimit të vjetër që e konsideron artin për art pa qëllim dhe ide. Sot ata nuk marrin çdo subjekt pa e parë atë nën prizmin sesa i shërben shoqërisë ky ose ay subjekt. Në këtë drejtim punonjësit e arteve figurative kanë përfituar nga mësimet e marksizmë-leninizmit, nga diskutimet krijonjëse mbi çështjet e artit dhe të estetikës dhe nga gjithë aktiviteti shqëror dhe politik që zhvillohet në vendin tonë.

Si paraqitet puna krijonjëse në artet figurative:

Duke marrë parasysh aktivitetin artistik në artet figurative gjatë këtyre 10 vjetëve, mund të themi se kualiteti artistik në përgjithësi është rritur dhe cilësija e veprave artistike qëndron më lart se kurdoherë tjetër. Gjithashtu duhet marrë parasysh se është rritur njëkohësisht dhe numuri i piktorëve të rinj, të cilët kanë dalë nga Liceu Artistik «Jordan Misja» dhe të ardhur nga akademitë artistike jashtë shtetit. Kjo ka rritur numurin e piktorëve dhe skulptorëve që dallohen në krijimtarinë e tyre. Ekspozita e vitit 1952, konkursi dhe ekspozita e vitit 1954 na treguan se piktorët dhe skulptorët mund të themi se kanë nisur një punë të rregullt dhe ata tani mendojnë seriozisht përritjen profesionale të tyre, ushtrojnë profesionin e tyre në rrugë të drejtë dhe se janë paraqitur gjithënjë më shumë piktorë e skulptorë me punime të mira e të kujdesëshme si nga ana e përbajtjes ashtu dhe e formës. Kjo tregon procesin e rritjes së punës krijonjëse në lëmin e arteve figurative.

Punonjësit e arteve figurative janë përpjekur të trajtojnë mirë formën dhe përbajtjen, janë përpjekur të kompozjnë dhe të vizatojnë më drejt figurat dhe objektet e veprave të tyre, pamvarësisht nga të metat që mund të konstatohen është bërë një përparim i dukshëm. Veprat e piktorëve dhe të skulptorëve na tregojnë se ata njojin më mirë çështjen e ngjyrave, trajtimin dhe modelimin e subjekteve të ndryshëm, tonet dhe dritat e hijet, të cilat, ku më pak e ku më shumë, ndiqen sipas rregulla të profesionit. Por kjo rrugë duhet forcuar akoma me bindje dhe duhet ndjekur me rigorozitet në punën krijonjëse të përditëshme duke bërë ushtrime të veçanta, domethënë duke u ngritur akoma më shumë nga ana profesionale për të forcuar krijimtarinë në art.

Çështja e ushtrimeve të përditëshme për piktorin dhe skulptorin, është e dorës së parë ashtu siç është për pianistin dhe instrumentistët e tjere, veçanërisht për neve në konditat e sotme, kur nuk kemi bërë një rrugë të rregullt të ushtrimit të profesionit tonë, e cila është penguar seriozisht në të kaluarën. Përsa i përket problemit të ngritjes profesionale ne duhet t'i kushtojmë një vëmëndje më të madhe, sepse kemi dobësi të theksuara, të cilat duken si në punimet e pikturës ashtu dhe në ato të skulpturës. Piktorët dhe skulptorët natyrisht jo në përgjithësi, nuk i japin rëndësin e duhur ndërtimit të figurave, nuk tregojnë kujdes të vizatojnë mirë figurat e tyre, të cilat në disa raste paraqiten me të meta të theksuara, me «disproporcione», sepse nuk bëhen ushtrime paraprake dhe ushtrime përvizatim. Ne kemi akoma dobësi përsa u përket vlerave tonale, të cilat nuk kryhen sipas procesit teknik, por në disa raste shumë thjesht dhe në shumë raste ka një ngatërrim të këtyre vlerave, të cilat

në vend që të jepin efektin e duhur, jepin efekt të kundërt. Ne mund të themi gjithashtu se nga një shpejtësim i përgjithshëm i punës, shokët artistë nuk thellohen dhe nuk nguimojnë per interpretim të materies. Çështja e materies për ne ka edhe merr një rendësi të veçantë si për pikturen ashtu dhe për skulpturën. Në të dyja këto degë trajtimi i materies paraqitet me të meta, sepse stofi, mish, objektet, hekuri, druri, natyra në përgjithësi, nuk të jep elektron real të materies ahe kjo vjen pikërisht sepse nuk studjohen me vëmëndje të veçantë dhe nuk merren ato në ambientin e tyre të plotë, në efektin e dritës dhe të hijes, të ngjyrës dhe të volumit. Prandaj, është e domosdoshme që piktorët, skulptorët të bëjnë ushtrime të përditëshme lidhur me ngritjen profesionale të tyre.

Për një krijimtarit të plotë dhe më të mirë ka rendësi të madhe studimi i natyrës së gjallë, studimi i historisë së popullit tonë dhe i jetës së përditëshme të tij. Ne konstatojmë se edhe në këtë drejtim kemi përmirësimë sepse në punime të ndryshme, punonjësit e arteve figurative kanë focuar më shumë rrugën e interpretimit realist duke qënë afër realitetit, duke shkuar kështu në rrugën e realizmit socialist në art. Ne kemi dobësi të cilat na pengojnë akoma për studimin e natyrës dhe të historisë së popullit tonë, sidomos preqatja dhe kujdesi për këtë punë duke u pajisur me një kulturë më të gjerë, me një ngritje ideologjike më të lartë dhe me një stërvitje teknike më të fortë. Çështjes së studimit të natyrës dhe të realitetit të jetës për artet figurative, i duhet dhënë një kujdes më i madh, sepse kjo përjashton çdo formë të jashtme të artit që është e dëmshme për artin tonë të ri, i cili ndjek shëmbullin e artit sovjetik dhe rrugën e artit socialist. Rruja e realizmit socialist në art duhet të tërheqi akoma më shumë vëmëndjen e punonjësve të arteve figurative për të patur një krijimtar më pozitive dhe më artistike. Punonjësit tanë të arteve figurative shkojnë drejt rrugës të realizmit socialist dhe mundohen që veproat e tyre të interpretojnë drejt realitetin e ngjarjeve në mënyrë krijonjëse, por ata duhet të kujdesen më shumë për një interpretim të drejtë dhe artistik duke studjuar personazhet e tabullove në realitetin e tyre duke e njohur më shumë këtë realitet sepse kemi shumë raste që punohet me fantazi, e cila të shpie jashtë realitetit, në formalizmë, ne skematizmë. Realiteti është burim krijimi për artin, domosdo duke përjashtuar një riprodhim mekanik të përciptë, i cili të shpie drejt në natyralizëm, që s'është gjë tjetër veçse një imitim i thatë i natyrës. Prandaj natyra duhet interpretuar dhe jo kopjuar. Këtë çështje ne duhet ta kemi parasysh. Ne mendojmë se tek ne tani për tani nuk ka ndonjë rrezik për natyralizëm, por piktorët dhe skulptorët duhet të tregohen më aktivë dhe të kenë me gjallëri në punën e tyre krijonjëse, të njojin realitetin dhe të studjojnë më thellë veproat e tyre në dritën e këtij realiteti.

Njohja e jetës, e realitetit, kërkon një kujdes të veçantë nga ana e artistit. Ay duhet të jetë në kontakt me këtë realitet, sepse sa më shumë të njihet me të aq më mirë do ta kuptojë dhe do t'a interpretojë. Prandaj artisti duhet të lidhet ngshtë me ngjarjet që zhvillohen, më përparimin e përditshëm, të vejë në fushë, më punët bujqësore, më uzinë, të takohet me puntorët, të njihet me fshatarin e kështu me rradhë, duke e parë jetën nga afër, më dritën e diellit. Nuk është e mundur të japoë një pëershkrim ose një tablo mbi ngjarjet pa i parë ato në jetë, nuk mund të njihet e reja përparimtare dhe vrulli i punëtorve, po nuk njohe punën e përditëshme. Nga kontakti që merr artisti me jetën duke shkuar atje ku puntori realizon detyrat e tij, artisti krijon një ide të qartë mbi botën reale, përvëç kësaj artisti duhet të lexojë shtypin dhe literaturë të ndryshme për të

zhvilluar fantazinë e tij. Këto e ndihmojnë artistin që në veprën e tij të krijojë një temë interesante dhe realiste. Njohja e realitetit, e jetës së popullit, e ndihmon artistin të mos kapë gjënë e zakonëshme ashtu si i paraqitet çdo gjë, por të kapë atë më tipiken dhe të zgjedhi figurat më aktive dhe më interesante që të përfaqësojnë të renë në kuadrot e tij.

Ka raste kur realiteti paraqitet artificial sepse pikërisht nuk shikohet me një interesim të veçantë, por shikhet në mënyrë të përgjithshme dhe të thjeshtë, p.sh. Shoku Vangjush Tushi në tabllonë e tij «Sheperi i parë» nuk ka zgjedhur tipat që i duhesin për tabllon e tij, por me sa duket mori çfarë i dolli përpëra, prandaj shumë prej figurave të tij nuk janë përfaqësonjës aktivë të puntorëve të industrisë së sheqerit. Ata paraqiteshin edhe me difekte proporcionale, mund të thuhet se ata kështu ishin në natyrë.

Pikërisht artisti duhet të zgjedhi dhe të krijojë dhe të mos bëjë çfarë i paraqitet dhe si e gjen në natyrë, por duhet të zgjedhë dhe asgjë nuk e pengon artistin që të zgjedhë personazhe aktivë për veprat e tij, të cilët të luajnë me të vërtet një rol aktiv në vendin ku e vendos artisti, sepse atëherë bëhen figura pa vlerë në vend që të jenë figura pozitive që me prezencën e tyre të entuziazmojnë.

Disa konsiderata të përgjithëshme për punimet që u paraqiten në konkurs dhe në ekspozitën vjetore:

Po marr me radhë disa vepra të pikturës dhe skulpturës, për të cilat do të flas mbi anët e tyre të mira dhe mbi dobësitet e tyre, duke i parë ato në gjendjen e sotme përsa i përket përparimit që është bërë nga ana e punonjësve të arteve figurative dhe përsa u përket të metave, që ata duhet të kenë parasysh në punën krijonjëse në të arthmen.

Tablloja me temë «Zotër të tokës», së cilës i u dha çmimi i parë i konkursit, veprë e piktorit Abdulla Emini, është një tablo me temë dhe me një përmbytje të mirë dhe realizimi artistik i saj qëndron më mirë se çdo realizim tjeter i piktorit Abdulla Emini. Tablloja «Zotër të Tokës», ka një temë të lidhur me fshatarësinë tonë, lidhur me një nga reformat më të rëndësishme të pushtetit popullor, Reformën agrare. Tablloja paraqet një të përgjithshme të bukur të figurave dhe të natyrës, e cila tërheq më shumë vëmëndjen tonë, ka gjithashtu disa grupe figurash që paraqiten mirë. Është për tu theksuar gjithashtu trajtimi i natyrës, realizuar me një temperament artistik, sidomos mëngjezi, i cili është trajtuar në mënyrë të bukur dhe tërheqëse. Trajtimi kromatik dhe artistik i natyrës dhe i së përgjithëshmes tregon një të arhme të lumbur të fshatarësisë sonë.

Në tabllonë e piktorit Nexhmedin Zajmi me titull «Prita Partizane», e cila fitoi çmimin e dytë të konkursit, gjemë anë të mira, të cilat na tregojnë se piktori në fjalë ka bërë përparime në punën e tij krijonjëse, ka një vendosje të mirë të kompozicionit si në tërësi ashtu dhe në veçanti, ka ballancuar mirë figurat, i ka vizatuar mirë dhe kjo është një anë me shumë rëndësi, domethënë të vizatosh dhe të kompozosh është një detyrë kryesore për piktorin. Vlen të theksojmë dhe punime të piktorëve të tjerë si p.sh. punimi i piktorit Angjelin Dodmasej me titull «Trimi i nanës», i cili fitoi çmimin e tretë. Piktori Dodmasej është paraqitur më mirë se në Ekspozitën e 1952-së; kjo na tregon se piktori i ri Dodmasej ka ecur përrapa në krijimtarinë e tij, si në vizatim ashtu dhe në trajtimin dhe ngjyrat. Gjithashtu vendosja e kompozicionit në kuadrin e tij ballancohet. Ky kuadër ka gjithashtu të mirë dhe efektin e dritave, të cilat i jepin kuadrit

në përgjithësi një efekt të bukur dhe vënë në dukje karakteristikat e ambjentit shkodran.

Piktorët Vangjush Mio, Vladimir Jani, Sadik Kaceli, Vangjush Tushi, Sali Shijaku, Kel Kodheli, Bukurosh Sejdini, Simon Rrota, Niqi Antoniu, Ibrahim Shehu etj. kanë paraqitur punime të qëndrojnë në një lartësi krijonjëse më të mirë se sa ato të vitit 1952 dhe kanë ekuilibruar në ekspositën e tanishme boshllëqet e ekspozitës të vitit 1952. Disa prej këtyre punimeve u vlerësuan me çmime të veçanta pikërisht sepse veprat e tyre kanë një paraqitje të mirë artistike.

Piktori Vangjush Mio, një piktor me talent, piktor peisazhist, paraqitet me peisazhe të Pogradecit, Vjeshta, Vjelja dhe prashitja e panxhar sheqerit. Këto punime na tërheqin vëmëndjen tonë. Piktori në punimet e tij paraqet fragmente nga fusha e Korçës, me tema interesante me ngjyra të bukur, transparente dhe karakteristike të vëndit. Peisazhi «Vjeshta» është i bukur dhe i trajtuar mirë; gjithashtu në planin e dytë të kuadrit «Vjelja e panxhar sheqerit» ka trajtuar bukur natyrën malore, ngjyra transparente dhe me perspektivë ajrore të bukur; por shoku Vangjush Mio ka një të metë në punimet e tija dhe lë në dorë të dytë, planin e parë të peisazheve të tija. Kjo duket akoma më qartë në kuadrin «Vjelja e panxhar sheqerit» për të cilin gjithë kuadri mban këtë titull dhe pikërisht për këtë duhej të theksohej më shumë plani i parë.

Kuadri i Sadik Kacelit me titull «Kalimi i divizionit të parë në veri» na tërheq vëmëndjen, sepse shoku Sadik Kaceli ka harmonizuar bukur këtë kuadër me ngjyrë grihio-blu të ngrohët, na tregon një agim të thellë. Piktori Sadik Kaceli ka bërë përparime të dukëshme lidhur me punën e tijë të mëparëshme, në këtë kuadër ay është munduar të krijojë diçka të bukur dhe ka arrijtur një harmoni dhe një vendosje artistike të peisazhit.

Piktori Vladimir Jani në punimet e tija tregon se ka aftësi krijonjëse dhe talent, ay ka trajtuar mirë kuadrin e tij me titull «Tre heronjtë». Na jep efektin e një brendije dhe sidomos efektin e dritës dhe të hijes, një cilësi e mirë e domosdoshme për piktorin. Trajtimi i materjes në kuadrin e Vladimirit është parë me kujdes dhe kjo është një anë pozitive.

Piktori Vangjush Tushi paraqitet me kostumin e «Dardhës» dhe me Buketin e «Luleve të malit». Këto dy punime janë realizuar mirë, Vangjush Tushi na tregon në këto dy kuadro një kujdes të veçantë në kërkimin e vizatimin dhe në vendosjen e tyre, në përdorimin e ngjyrave dhe në efektin e dritës dhe të hijes. Në këto dy kuadro ka një elegancë dhe të dy këto kuadro vlerësojnë punën krijonjëse të Vangjush Tushit.

Piktori Sali Shijaku, piktor i ri që ka mbaruar Liceun artistik «Jordan Misja» si punë kryesore ka kuadrin me titull «Kthimi». Sali Shijaku punon me vullnet, është i kujdesëshëm si për kompozicionin ashtu dhe përvizatimin, ai kërkon me kujdes materjen dhe efektet e dritës dhe të hijes, ai ka vepruar në një sfond të zi (të errët) që zakonisht është i vështirë të manovrohet.

Piktorët e tjerë, Bukurosh Sejdini, Simon Rrota, Niqi Antoniu, Ibrahim Shehu, etj. janë paraqitur me punime të cilat merren në konsideratë.

Punimet e pllakatit dhe të karikaturës që u paraqitnë në konkurs, dhe në ekspozitë janë punime që kanë vlera krijonjëse artistike. Kjo tregon se në të arhmen të dy këto gjini do të zhvillohen më shumë dhe duhet të zhvillohen më shumë sepse janë dy gjini që kanë një funksion agitacioni dhe propagande dhe përsa i përket këtyre dy gjinive duhet të tregohet një kujdes i veçantë për preqatitjen e kuadrit të ri. Vëmë re se në karika-

turë dhe sidomos në pllakat éshtë kaluar më shumë në rrugën e kopjes, kjo éshtë një e metë e madhe që duhet evituar sa më shpejt dhe punonjësit të orientohen në punën krijonjëse indipendente, prandaj këta duhet të studojnë dhe të ushqehen më shumë. Punonjësit e karikaturës dhe të plakatit siç janë Zef Bumçi, Bashkim Dizdari, Dhimitraq Mborja, janë të rinj me talent, kanë të gjitha mundësitet që t'i kushtohen një pune indipendente krijonjëse.

Sektori i skulpturës në ekspozitë u paraqit me më pakë punime, me gjithkëtë aty ka punime të vlefshme, të cilat janë realizuar mirë. Busti i dëshmorit Mihal Duri, gdhëndur në mermer, vepër e skulptorit Lazar Nikolla, fitoi çmimin e parë. Ai në këtë punë ka arrijtur të na japë një bust, një figurë, një portret që të tèrheq vëmëndjen për realizimin e tij. Vendosja dhe prerja e bustit i jepin figurës së dëshmorit një pamje heroike, shprehja dhe karakteristika të veçanta të fytyrës e bëjnë bustin që të marrë një pamje të bukur dhe tèrheqëse. Skulptori Lazar Nikolla ka kërkuar dhe ka arritur të japë disa efekte të bukura në mermer, veçanërisht në fytyrën e dëshmorit. Në konkurs éshtë paraqitur një grup skulptural nga Odhise Paskali, një skulptor me talent, i cili ka krijuar vepra që dëshmojnë përfshirët e tij krijonjëse. Grupi «Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë» fitoi çmimin e dytë, vepër e bëre për ekspozitën e 10 vjetorit të çlirimtë. Grupi skulptural i skulptorit Odhise Paskali, paraqitet me një vendosje të thjeshtë, por të lezeçme dhe tregon dy figura në një veprim të përbashkët. Ky grup skulptural në përgjithësi éshtë vendosur mirë dhe përsa i përket të përgjithëshmes éshtë realizuar mirë dhe na jep një përshtypje tèrheqëse. Skulptori Odhise Paskali me bustin e shkencëtarit të çquar Pavlov ka bëre një punë krijonjëse të mirë, aty ka një studim më të thellë dhe një trajtim më estetik, ku të bije në sy shprehja e ndjenjave të brendëshme të shkencëtarit.

Punimet e skulptorit Janaq Paço bustet N.V. Tomski dhe Stahanovisti janë dy portrete që tregojnë se shoku Janaq Paço ka kërkuar të na japë materjen dhe ka arritur një ndërtim të mirë të figurave, këto janë dy studime të mira të skulptorit Janaq Paço.

Punimet e skulptorëve të tjerë, të shokëve Dhimitër Cani dhe të skulptorëve të rinj Dhimitër Buda, Sami Turku, Llukan Bushi dhe Thoma Thomaj, na tregojnë se kanë punuar seriozisht, janë kujdesur përfshirë formën, përfshirët përfshirët dhe modelimin e figurave dhe në përgjithësi kanë arritur të paraqesin në ekspozitë punime të pëlgjeshme. Po kështu mund të themi edhe përfshirët e rinj, të cilët jo vetëm që kanë marrë pjesë, por janë paraqitur dhe me punime që zënë një vend të mirë në ekspozitë. Punimet e tyre na tregojnë se ata janë duke punuar me dashuri në profesionin e tyre.

Cilat janë të metat që konstatohen në vijë të përgjithëshme në këta punime:

Në kuadrin e Abdulla Eminit «Zotër të tokës» ne shohim se piktori i ka vendosur të gjitha figurat në vijë horizontale dhe krijon në to një monotonji dhe një staticizëm megjithëse piktori éshtë munduar që t'i ndajë figurat në grupe të veçuara. Nuk duket e qartë ku éshtë pika kulminante e kuadrit, ndarja e tokës, matja apo grupi me planin në dorë. Kjo rrjedh nga që kuadri duhet të ketë një pikë kulminante rreth së cilës të vërtitet intereseti i figurave të tjera si p.sh. në Zaporozhasit e Rjepinit na tèrheq vëmëndjen dërgimi i letrës Sulltanit, aty éshtë pika kulminante. Në kuadër nuk del si duhet vendosja e figurave, distancat njera nga tjetra dhe ndërmjetëset si dhe përspektiva ajrore; ka një uniformitet në tonet e në

hijet e dritat, duke i lidhur këto me ardhjen e drites nga një drejtim kryesor domethënë; ardhja dhe shpërndarja e saj në gjithë figurat e objektit që janë vendosur në kuadër. Kjo çështje ka krijuar në kuadër një të përgjithëshme dhe një vlerë dhe mund të themi një vlerë tonale me pakë diferenca. Në disa vepra arti, shumë herë ngatërrrohet titulli i kuadrit me veprimin, p.sh., në kuadrin e shokëve Sadik Kaceli dhe Sali Shijaku në punimet «Kalimi i Divisionit të parë në veri» dhe i «Kthimit», në të parën piktori éshtë kujdesur të harmonizojë çdo gjë në kuadër dhe pikën kulumante të saj e ka në majën e malit, pikërisht aty ku agan drita, ndërsa pjesët e tjera të kuadrit janë në hije të përgjithëshme sidomos figurat, njerrëzit, partizanët, pér ata që flitet nuk duken. Ne mendojmë se titulli i kuadrit «Kalimi i divisionit të parë në veri» që lidhet me kalimin e lumi Shkum bin nga ana e partizanëve, aty duhet të ishte pika kulumante e kuadrit, sepse ky éshtë aksioni përfshirët të cilin flitet dhe kjo gjë duhet të tregohet, përvëç kësaj shoku Sadik Kaceli nuk ka treguar tamam efektin e kalimit të lumit dhe figurat nuk janë konstruktuar si duhet. Ndërsa në pikturen e Sali Shijakut me titull «Kthimi», partizani që kthehet fitimtar nga lufta éshtë vendosur në hije, ndërsa fytyra e nënës që pret të birin éshtë në drithë domethënë e kundërtat, atëherë titulli i kuadrit duhej të ishte ndryshe: «Pritja» sepse pikërisht në këtë kuadër del më shumë nëna që pret se sa partizani që kthehet dhe po të marrim kuadrin e Rjepinit «Nuk e pritshim» të gjitha figurat kanë një interesim të përbashkët. Piktori në zgjedhjen e temës éshtë influencuar nga ky kuadër, përsa i përket temës.

Një e metë tjetër që ka rëndësi na duket se éshtë përdorimi i efekteve të drithës dhe të hijeve, si p.sh., te piktori Nexhmedin Zajmi në tablonë e tij «Prita partizane», ku dritat janë arritur në një ton të përgjithshëm, shumë të ulët sa që duket se unifikojnë gjithë kuadrin në një efekt të dobët kontrastesh, pra nuk del këtu gjallëria dhe jeta e personazheve, të cilët janë në një aksion të rëndësishëm. Kjo gjë duket ose vihet re edhe në trajtimin e natyrës shkëmbore, e cila nuk na jep një materje të gurtë, por një preqatitje butaforije, pikërisht sepse i mungon trajtimi i duhur i materjes dhe i efektit të dritave. Piktori Nexhmedin Zajmi nuk ka arritur gjithashtu të përcaktojë në masën e duhur distancën dhe përspektivën ajrore në grupin e autokolorës. Figura qëndrore që ka dashur të vendosi piktori, skuadër komandantin, i ka dhënë një veprim statik, gjithashtu nuk ka kërkuar të japë një tip karakteristik të natyrës sonë, veçanërisht shprehja e tij nuk éshtë arritur mirë, pra mund të themi se kjo figurë e ka dëmtuar në përgjithësi kuadrin e shokut Nexhmedin Zajmi, ndërsa figurat e tjera të kuadrit përgjithësisht janë vendosur mirë.

Një rëndësi të veçantë ka përgjithë gjinitë e arteve figurative vizatimi. Në punimet e ekspozitës ka të meta përsa i përket vizatimit, punimet e piktorëve Vangjush Tushi dhe Aristotel Papa me titull «Sheperi i parë» dhe «Preqatitje përfshirë aksion» të paraqitura në konkurs, nuk u pranuan në ekspozitë, mbasi qenë me të meta themelore nga ana e kompozicionit, e vizatimit dhe e trajtimit të përgjithshëm të tyre; ne shohim se shoku Vangjush Tushi dhe shoku Aristotel Papa, kanë mundësi dhe janë në gjëndje të krijojnë më mirë. Na duket se këta dy shokë janë shpejtuar shumë në këto dy punime dhe se nuk kanë patur natyrën përpëra. Vizatimi dhe trajtimi i materjes ka çaluar plotësisht në këto dy punime, figurat nuk kanë qenë të konstruktuar në marëdhënie njera me tjetren, nuk janë respektuar ligjet e hijes dhe të drithës, gjithashtu shprehja e figurave nuk ka qenë në gjëndje të mirë, në të dyja punimet figurat kanë qenë të shtrëmbëruara në natyrën e tyre, pa skelet dhe të ngjajshme njera me tjetren.

Artisti ne trajtimin e veprave të tij duhet të kërkojë figurat më interesante, më të bukura, më proporcionale dhe jo çfardo figurë që i paraqitet, duke i krijuar ato ashtu siç janë, sepse atëhere kemi rënë në natyralizëm dhe në formalizëm dhe në gabime profesionale. Prandaj duhet të punohet me kujdes dhe me guxim për të krijuar një vepër arti.

Edhe në kuadrin «Zotër të Tokës» ka figura që janë të mangëta në konstruktimin e tyre, ato të jatin përshtypjen si figura të shkurtra dhe kjo e metë sigurisht që bije në sy në figurat e kuadrit «Zotër të Tokës». Disa të meta të tjera shikohen në kuadrin e Vladimir Janit, i cili ka disproporcione të figurave me të objektit, nuk janë ruajtur dhe krahasuar ato të planit të parë me ato të planeve të tjera si dhe objektet njera me tjetrën janë në disproporcion. Një gabim i tillë vihet re në kuadrin e shokut Vladimir Jani. Gjithashtu shoku Vladimir Jani në përdorimin e dritave dhe të hijeve nuk ka një ndërmjetëse të domosdoshme, por kalohet me një herë nga drita në hije. Ky kontrast është kontrast efekti, duke sakrifikuar ndërmjetësen e domosdoshme për t'i dhënë kuadrit një harmoni dritash.

Piktori Kel Kodheli ka bërë një punë për të cilën cquhet për punimet e tij të mëparshme; pjesa e sipërme e kuadrit natyra malore është arritur mirë, kurse figurat në përgjithësi nuk janë studjuar si duhet, nuk janë vendosur mirë, ka monotonitë në hijet dhe në dritat dhe një përzjerje dritash dhe hijesh. Vizatimi në shumë raste çalon sepse ka figura që në vendosjen e tyre kanë humbur ekuilibrin dhe figura bëhet e pa-aftë për detyrën që i ka ngarkuar piktori. Shoku Kodheli ka të gjitha mundësitetë që të ecij përpara. Një numur të metash të tjera ka edhe në sektorin e skulpturës, të pllakatit dhe të karikaturës. Grupi «Muratorët» të skulptorit Lazar Nikolla, çalon nga ana e kompozicionit, janë figura që nuk jetojnë sëbashku, nuk është gjetur momenti i përshtatshëm i vendosjes së tyre, nuk janë në lartësinë e duhur të krijimtarisë, gjithashtu skulptori nuk ka vizatuar e konstruktuar figurat dhe nuk ka trajtuar materjen për t'u dhënë figurave jetë dhe gjallëri. Me sa kuptohet skulptori është shpejtuar në këtë bocet dhe mendojmë se ka punuar më shumë me fantazi se sa me natyrën përpara, prandaj ka rënë në të tilla gabime. Shoku Lazar Nikolla në bustin e dëshmorit «Mihal Duri» ka një diferençë prandaj artisti duhet të ketë gjithmonë parasysh të vlerësojë sa më shumë krijimtarinë artistike. Në punimet e skulptorit Odhise Paskali, sidomos në grupin e «Aleancës së klasës puntore me fshatarësinë», ka një të përgjithshme të shpejtë, një efekt të shpejtë, skulptori nuk ka hyrë në thellësi e në detaje dhe nuk i jep një trajtim të plotë formave dhe materjeve, duke modeluar me kujdes gjithë pjesët, gjë e domosdoshme për veprën e artit. Ndërsa në figurën e shkençtarit rus Pavlovit ka arritur rezultate më të mira artistike si nga pikëpamja e shprehjes, tipit dhe të portretit.

Ka shumë raste akoma që veprimi i dritave dhe i hijeve, vizatimi, shprehja dhe marëdhëniet e figurave njera me tjetrën dhe sidomos tipi i jonë me tërë karakteristikat e tij, nuk studjohen mirë.

Në lëmin e pllakatit shokët pllakatistë kanë rënë në gabime sidomos në karakteristikat e tipave të natyrës sonë, të cilat nuk janë studjur por përkundrazi mund të themi se janë kopjuar dhe këtë e vërteton pllakati në ekspositën e 10 vjetorit të çlirimt, punuar nga Bashkim Dizdari, ku karakteristikat e tipave janë më shumë figura hindjane ose aziatike, se sa tipa shqiptarë. Çështja tipit dhe e tipizimit në përgjithësi duhet të na preokupojë shumë. Kjo çështje zgjidhet vetëm duke bërë studime të portretit tonë nacional. Në përparimin e arteve figurative dhe në përgjithësi të arteve na ka ndihmuar eksperienca e artit sovjetik dhe e pu-

nonjësve të artit sovjetik, konkretisht shokët Reshetnikov dhe Tomski me sugjerimet e tyre dhe bashkëbisedimet mbi disa probleme të krijimtarisë sonë nationale si mbi çështjen e studimit të natyrës, studimi i realitetit dhe i jetës së masave punonjëse, mbi stërvitjet individuale të punonjësve të arteve figurative dhe mbi çështjen e interpretimit të ngjyrave të natyrës sonë çështje këto që kanë ndihmuar dhe që do të ndihmojnë në rritjen profesionale të punonjësve të arteve figurative. Piktorët dhe skulptorët tanë kanë filluar që këto çështje t'i vënë në praktikë, sidomos çështien e ngjyrës, të cilën e vërtetojnë edhe veprat e ekspositës sonë të fundit.

Gjatë dy vjetëve të fundit Lidhja e artistëve ka organizuar herë pas herë diskutime krijonjëse, të cilat kanë ndihmuar në punën krijonjëse. Kjo duhet organizuar në të arthmen akoma më mirë dhe sidomos takime të shpeshta me piktorët dhe skulptorët, duke diskutuar rrëth punimeve në veprim dhe duke kaluar në një kritikë jo akademike, por aktive dhe shoqërore. Punonjësit e arteve figurative, duhet të vënë të gjitha forcat e tyre krijonjëse për përparimin kolektiv të punonjësve të arteve figurative, për lavdinë e kolektivit të arteve figurative dhe jo për lavdinë personale, sepse kur është arritur lavdia e kolektivit atëherë pa tjetër edhe kënaqësia personale vjen vetveti.

Aktiviteti artistik i gjersotshëm në sektorin e arteve figurative, nataregon se para punonjësve të arteve figurative shtrohen probleme të cilat duhet të zgjidhen me punën krijonjëse të përditëshme të tyre. Këto probleme janë. Njohja e gjithanëshme e jetës të popullit tonë, në qytet dhe në fshat për një interpretim të drejtë dhe realist, forcimi dhe zgjedhja e një tematikë më të plotë, lidhur me të kaluarën dhe të tashmen e popullit tonë, duke u larguar nga një temë e njëanëshme. Problemi i ngritjes profesionale e cila vendos për një përparim më të shpejtë dhe për nië kualitet artistik më të lartë, ky problem duhet kuptuar mirë nga artistët, të cilët duhet të bëjnë ushtrime të përditëshme, dhe do të rritë pa tjetër mjetërinë e artit. Në këtë rast vizatimi merr një rëndësi të veçantë.

Punonjësit e arteve figurative t'i kushtojnë një kujdes të vecantë formës dhe përbajtjës së veprave të tyre. Përsa i përket formës artistët të niohin karakteristikat dhe rrëthanat e veçanta të jetës dhe të rritin aftësitetë e tyre mjeshtërore. Të niohin natyrën tonë, ngjyrën nationale, të niohin rrëthanat në të cilat do të vënë temat dhe personazhet e veprave të tyre. Të tregohet kujdes më i madh në trajtimin e figurave dhe sidomos në interpretimin real të strukturës së tipave nationale.

Përsa i përket përbajtjës, artet figurative e kanë përmirësuar këtë, por artistët duhet të kenë parasysh se duhet të zgjidhet nië tematikë e mirë, një tematikë që të traitojë probleme shoqërore, politike dhe historike lidhur me të kaluarën dhe të tashmen e popullit tonë.

Një problem tjetër me shumë rëndësi për artet figurative është çështja e ngjyrave. Punonjësit e arteve figurative sidomos piktorët duhet t'i jalin një rëndësi më të madhe trajtimit të ngjyrës, çështie që e kemi diskutuar së bashku dhe që paraqitet akoma me të meta. Punonjësit e arteve figurative t'i kushtojnë një kujdes më të math ngritjes së tyre ideologjike dhe politike; kjo do t'i paisë me njohuri dhe botkuptim të ri mbi jetën, e cila i shërben krijimtarisë artistike dhe e orienton krijimtarinë e artistëve në një rrugë më të shëndoshë. Punonjësit e arteve figurative të studjojnë marksizmë-leninizmin, problemet e estetikës, probleme teorike të realizmit socialist, sepse kështu do të paisen me njohuri

teorike që do t'i shërbejnë ngritjes së nivelit kultural dhe ideologjik të tyre dhe zhvillimit të arteve figurative në vendin tonë.

Punonjësit e arteve figurative, si gjithë punonjësit e tjerrë të vendit tonë, të mobilizohen më shumë për një punë krijonjëse në art dhe veprat e tyre t'i shërbejë mirëqenies së masave punonjëse, ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së paqes dhe ta bëjmë veprën e artit një mjet të fuqishëm dhe edukonjës.

Ne punonjësit e arteve figurative kemi nevojë për një kritikë të mirë të punës sonë, sepse ajo do të shpjerë më tej krijimtarinë artistike. Kjo kritikë të mirëpritet dhe të jetë në fryshtë e shqipëritë dhe të bashkëpunimit, sepse atëherë ajo është e fryshtë e dobiprurëse për gjithë punën tonë krijonjëse. Ne duhet të vlerësojmë vërejtjet që bën publiku për veprat e artit dhe aktivitetin artistik në përgjithësi si dhe vërejtjet e njeri tjetrit dhe të miren ato si një ndihmë konkrete për të mirën e punës duke i vlerësuar si duhet me një kujdes të madh, duke u nisur jo nga qëllime personale, por nga qëllime të drejta, gjithmonë në dobi të zhvillimit të arteve figurative në vendin tonë.

Lidhja e Artistëve të Shqipërisë, Komiteti Drejtongjës i ardhshëm dhe komisioni i arteve figurative duhet t'i kushtojnë një kujdes më të madh krijimtarisë në lëmin e arteve figurative dhe zhvillimit të mëtejshëm të të gjitha gjinive në artet figurative.

Ne jemi të sigurtë për një të ardhme më të shkëlqyer të arteve figurative sepse kemi ndihmën e pakursyer të Partisë dhe Qeverisë sonë si dhe eksperiencën e artit më të përparuar në botë, artit sovjetik.

DHORA LEKA

Krijimtaria muzikore *)

Ne jemi mbledhur për t'i bërë një analizë punës sonë krijonjëse në muzikë gjatë vitit që kaloi, viti i dhjetë që nga dita e çlirimit të Atdheut tonë, për të parë sukseset, të metat tona, perspektivat dhe detyrat që na dalin përpara. Sigurisht në një referat, nuk mund të preken thëllësishët të gjitha problemet e krijimtarisë sonë. Është mirë që shokët kompozitorë, në diskutimet e tyre të plotësojnë të gjitha boshllëket që mund të kenë mbetur në referat. Një vend të rëndësishëm në këtë referat zë analiza që u është bërë veprave të paraqitura në konkursin e shpallur nga Ministria e Arësimit dhe Kulturës me rastin e festës së madhe të 10 vjetorit të çlirimit të Atdheut tonë, si dhe detyrat që na dalin përpara.

Zhvillimi i muzikës në vëndin tonë dhe sidomos rezultatet e konkursit tregojnë se brënda një kohe të shkurtër tek ne janë arritur sukseset të rëndësishme në këtë drejtim. Në pragun e festës së çlirimit ne duallëm me operetën e parë nationale, grupet profesioniste dhe ato të amatorëve ekzekutuan pjesë orkestrale, oratorio, romanca dhe të tjera pjesë nga kompozitorët shqiptarë.

Ky është një sukses i madh për krijimtarinë tonë muzikore, po të krasojmë kohën relativisht të shkurtër prej çlirimit e këndej.

Sukseset që u arritën gjatë këtyre dhjetë vjetëve në artin e muzikës tregojnë se tek ne u krijuan të gjitha konditat për ngritjen e muzikës sonë profesionale dhe për një art të shëndoshë oë t'i përgjigjet qind për qind kërkeseve gjithënjë më të mëdha të popullit tonë.

Muzika e jonë është zhvilluar në bazë të udhëzimeve të Partisë, në bazë të metodës së realizmit socialist, e cila është e vetmja metodë e drejtë e zhvillimit të artit në përgjithësi. Kompozitorët tanë kanë bërë përpjekje për ta përvetësuar këtë metodë, për të paraqitur në veprat e tyre realitetin e mrekullishëm të jetës sonë, në zhvillimin e tij revolucionar. Muzika e jonë i ka flakur më n'janë me përbuzje tendencat e huaia. Muzika e jonë s'ka asgjë të përbashkët me muzikën e degieneruar të imperializmit luftënxitës me xhazin e çmëndur amerikan, që shpreh histerizmin e luftës së imperializmit.

Përpara se të hyj në analizën e veprave, dua të tregoj kriterin që kam ndiekur. Jam përqëndruar më pak në anët pozitive të veprave, jo sepse këto janë të pakta. Gjatë dhjetë vjetëve ne e kemi jetuar vetë rrugën e krijimtarisë muzikore dhe po të shohim këtë rrugë ka një seri të mëdha suksesesh që herë pas here janë vënë në dukje. Kush prej nesh nuk e di se gjatë dhjetë vjetëve prej çlirimit e këndeje janë kompozuar me qindra këngë që në periudhat e caktuara kanë jehuar dhe jehoinë edhe sot kudo?

Kush mund të mendonte se në një kohë kaqë të shkurtër do të rriteshin dhe grupe ekzekutoniës profesionistë dhe diletantë oë të vinin në skenë onera si «Rusallka» dhe «Ivan Susanin», operetën e parë nationale

*) Referat mbajtur në mbledhjen plenare të muzikantëve dhe kompozitorëve

tona, emisionet e radio Tiranës do të çalojnë përsa i përket muzikës së kompozitorëve shqiptarë.

Njerzit tonë, duan që në skenën tonë të mos ketë p.sh. vetëm koncerte korale apo vokale, ose valle me një orkestrinë të vogël. Njerzit tonë kanë parë edhe opera, dinë të shijojnë baletin. Prandaj, një vëmëndje të madhe duhet t'i kushtojmë në krijimtarinë tonë, punimit sinfonik të vallave tona, ecjes drejt ngritjes së muzikës orkestrale në vendin tonë – suitave, uverturave, fantazive, rapsodive etj.

Sidomos masat tona i tërheq shumë zhanri i operetës. Ne në skenën tonë pamë të parën operetë nationale. Rruja e celur për këtë gjini duhet të pasurohet, me dy, tri, katër ose më shumë opereta me subjekt nga jeta e jonë.

Cështja e të kapurit drejt të tematikës është një nga pikat më kryeso-re në krijimtarë.

Në krijimtarinë tonë muzikore, pothuajse të gjitha veprat janë në tematikën aktuale. Kjo është një anë pozitive.

Por që të mundim ne të jemi në lartësinë e duhur të paraqitjes drejt të realitetit tonë, që ne të paraqesim drejt punëtorin tonë në punën e tij heroike në minierë apo uzinë, që të nxjerrim drejt tiparet e fshatarit tonë punonjës, duhet që ne të njohim së afërmim rrahjen, e pulsit të tyre — të jetojmë me 'ta, jo vetëm nëpërmjet të gazetës, por edhe në fabrikë, në minierë, në kooperativën bujqësore. Sigurisht kur ne shkruajmë muzikë, apo poeti libretin a poezinë nga tavolina e dhomës së punës, sigurisht, ato do të dalin të zbeta sado mirë që të na punojë fantazija.

Prandaj, ne duhet të krijojmë të atilla kondita në krijimtarinë tonë, që të jemi sa më afër punonjësve tonë. Të organizojmë ekipe p.sh. kompozitorësh e shkrimitarësh e të vemi së bashku në minierë. Atje do të shohim me të vërtetë heroizmin e njerzve tonë të rinj, ndërtönjës të socializmit, patriotizmin e tyre të flaktë për Atdheun tonë.

Përpara nesh shtrihen përspektiva të mëdha për lulëzimin e artit tonë, ne këtu shtrojmë plane, marrim detyra dhe angazhime për t'i bërë realitet të gjitha këto. Dhe ne do t'i bëjmë, pse kemi ndihmiën e madhe të Partisë sonë, të Pushtetit tonë, dashurinë e popullit tonë që ka etje për art dhe kulturë. Por në botë ka dbe forca të errëta, që nuk duan të lulëzojë arti, kultura, që nuk duan që popujt e lirë të gjëzojnë. Këta ju i njihni të gjithë.

Janë manjatët e Uollstritit që kërcënojnë botën me bomba atomike me hidrogen, që duan ta shkrojnë planetin tonë, të shuanë gjithë rezultatet e artit dhe kulturës që njerëzimi ka grumbulluar shkuj me radhë.

Po njerzimi sot ka zot. Popujt po e marrin fatin e tyre në duart e tyre dhe i thonë ndal imperializmit të shfrenuar.

Sot në të gjithë botën ka shpërthyer lëvizja e pa parë ndonjëherë e njerzëve që luftojnë për paqen, që i dalin zot jetës së tyre, kulturës, shkencës.

Thirrjes së Byrosë së Këshillit Botëror të Paqes, lëshuar më 19 Janar të këtij vjeti, në lidhje me rimilitarizimin e Gjermanisë perëndimore dhe preqatitjes së luftës atomike, iu përgjigjen menjëherë njerzit e shkencës, artit, kulturës.

Ne, kompozitorët e Shqipërisë, bashkojmë zërin dhe përpjekjet tonë me gjithë njerëzimin përfparimtar, me shkencëtarët, artistët, poetët përfparimtarë të katës, dhe jemi gati me çdo kusht të mbrojmë Paqen, të punojmë përlulëzimin e artit në vëndin tonë, vënd i pandarë nga kampi i madh i paqes, demokracisë dhe socializmit.

BAKI KONGOLI

Aktiviteti i Lidhjes së Artistëve prej krijimit deri më sot *)

Në tetor të këtij viti mbushen plot tre vjet që nga dita e krijimit të organizatës së Lidhjes së artistëve të R.P. të Shqipërisë. Krijimi i Lidhjes është një ngjarje me rëndësi rë jetën artistike e kulturale të vendit. Në kujdesin atçor të Partisë dhe Qeverisë sonë popullorë punonjësit tanë të artit për të parën herë në historinë e popullit tonë krijuan organizatën e tyre, e cila i ka ndihmuar ata në punën krijonjëse dhe ka qenë vatra nga ku ata kanë përfituar nga eksperiencia e punës, nga eksperiencia e artit sovjetik. Lidhja e Artistëve ka ndihmuar punonjësit tanë të artit, për të venë në jetë orjetimin e partisë, përti pajisë anëtarët e kandidatët e saj me ideologjitet e estetikës marksiste-leniniste, i ka ndihmuar për t'i kapur drejt cështjet e krijimtarisë dhe të zgjedhin subjekte e tema nga jeta e popullit tonë në mënyrë që veprat e tyre të kontribuojnë në edukimin e masave popullore, në ndërtimin e socializmit dhe në mprojtjen e paqes e të atdheut.

Me gjithë që puna e Komitetit drejtonjës së Lidhjes ka qenë në bazë punë shoqërore, ajo ka ndihmuar antarët e kandidatët në shumë cështje e probleme të ndryshme që i përkasin punës krijonjëse dhe zhvillimit të mëtejshëm të artit tonë në përgjithësi.

Kështu konferencat e leksionet me karakter ideologjik e profesional të zhvilluara çdo vit i kanë vënë ata në dijeni dhe i kanë skjaruar në shumë cështje të rëndësishme që i përkasin rritjes së nivelit artistik në krijimtarë, zgjedhjes së një tematikë të përshtatshme, lidhjes së punës së tyre me problemet politike e ekonomike të Partisë e të Qeverisë sonë. Në punën e tij Komiteti drejtonjës ka patur si piknisje vendimet e udhëzimet e Partisë e të Komitetit të saj Qëndror, të cilat bëjnë fjalë mbi letërsinë dhe artin në vendin tonë dhe është përpjekur që t'i vejë në jetë ato.

Çdo vit Lidhja ka organizuar diskutime krijonjëse mbi veprat e prodhua nga anëtarët e saj në pikturë, skulpturë e muzikë. Kështu në diskutimet krijonjëse që janë organizuar për veprat muzikore kompozitorët janë ndihmuar oë të njohin konkretisht të metat e tyre t'i ndrejnë këto, ta lidhin më mirë brendinë me formën, të përdorin një gjuhë muzikore të përshtatëshme dhe të përmirësojnë veprat e tyre nga ana e nivelit artistik. Këtu mund të përmendim analizat që i janë bërë veprave të kompozitorëve Kono, Trako, Dungu, Uçi, Sokoli etj. Në pikturë janë marrë në diskutim veprat e N. Zajmit, Abdulla Eminit, Qamil Grezdet, në skulpturë janë marrë në diskutim veprat e Janaq Paços, Kristina Hoxhit, Lazar Nikollës etj. Jo vetëm skulptorët e interesuar por edhe të tjerët kanë përfituar nga ana profesionale në këto diskutime.

Vëç këtyre nga Komiteti drejtonjës janë organizuar edhe konfe-

*) Raport i mbajtur në mbledhjen plenare të njerzve të artit mbi aktivitetin e organizatës së Lidhjes së Artistëve.

renca mbi biografi kompozitorësh, piktorësh e skulptorësh të mëdhenj e njerëz të tjerë të shqar të artit siç janë konferencat për Glinkën e Çajkovskin, Dvorzhakun e Smetanën, Shopenin, Prokofjevin, Aleksandër Moisium, Repinin, Vera Mukinën, është folur mbi punimet e Nëprinçevit, mbi Brulcvin, janë bërë konferenca mbi arkitekturën Sovjetike etj.

Për t'i ardhur në ndihmë kompozitorëve të rinj janë organizuar kurse të armonisë e të formave muzikore. Lidhja ka organizuar ekipe piktorësh në qendra të ndryshme pune ka vizituar studiot e piktorëve dhe skulptorëve duke i ndihmuar ata me këshilla e sugjerime — Veç kësaj komiteti drejtonjës i Lidhjes në bashkëpunim me Shoqerinë e Miqësisë kanë organizuar në sallat e Shqërisë punimin e leksioneve të ndryshme mbi muzikën dhe artet figurative sovjetike. Janë projektuar filma pas këtyre leksioneve mbi piktorë të shqar rusë dhe janë dhënë koncerthe pas konferencave muzikale. Një ndihmë e madhe i është dhënë piktorëve, skulptorëve si edhe kompozitorëve tanë nga takimet që ika organizuar Lidhja me njerëzit e artit sovjetik dhe të demokrative populllore që kanë vizituar herë pas here vendin tonë. Kështu takimet me kompozitorët sovjetikë Karakarajev e Tulikov me piktorin Reshitnikov dhe skulptorin Tomski ka qënë shumë fryshtës për punën e artistëve tanë. Këshillat e shokëve sovjetikë i kanë ndihmuar mjaft ata në punën e tyre që dhe të përfitojnë nga eksperiencia e artit sovjetik.

Gjatë këtyre viteve të jetës së Lidhjes, Komiteti Drejtonjës ka marrë në studim një seri problemesh të ndryshme që i përkasin zhvillimit të mëtejshëm të artit tonë të ri ndër të cilat mund të përmendim studimin e muzikës scenë populllore, mbi vallet e folklorin tonë, mbi instrumentat popullore, janë ngritur komisione të veçanta për të parë procedimin e punës mësimore në muzikë e vizatim në qytetet Tiranë Elbasan etj., është mbikqyrur veprintaria artistike në grupet profesioniste dhe t'amatorëve, janë organizuar mbledhje të ndryshme me piktorë dhe skulptorë për të parë gjendjen e punimeve, janë shpërndarë leksione të shaptilografuara më materjal teorik mbi çështjet teknike të pikturës, skulpturës, muzikës etj. Kryesija e Lidhjes ka ndërhyrë pranë organeve të pushtetit duke i sigruar leje krijonjëse njerzve të artit që kanë marrë zotime për prodhime veprash.

Gjatë vitit 1954, sidomos gjatë gjashtëmijorit të dytë të këti viti, komiteti dreitonjës ka patur si problem kryesor mobilizimin e të gjithë anëtarëve të Lidhjes për t'u paraqitur me vepra sa më të mira e me vlerë artistike në konkursin e shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës për ndër të festës së madhe të 10-vjetorit të çlirimit.

Shumë kompozitorë, piktorë e skulptorë janë ndihmuar në vend gjatë punimit të veprave të tyre që do të paraqisin në konkurs. — Shokë të kryesisë dhe të komitetit drejtonjës kanë punuar për organizimin e ekspozitës së arteve figurative që u hap më 29 nëndor në pragun e festës së madhe të 10-vjetorit të çlirimit.

Gjatë vitit 1954 u korrën suksese të mira në lëmin e krijimtarisë si nga ana e sasisë ashtu edhe e cilësisë. Në artet figurative u prodhuan nga piktorët 62 vepra të ndryshme, nga skulptorët 18 vepra, në muzikë u kompozuan 70 këngë masash e për fëmijë, 8 romanca, 6 tabllo muzikore, 2 oratorio, 4 valcér, një operetë e një kantatë.

Me gjithë këto rezultate ne mund të themi me plot gojën se me gjithë arsyet objektive sikurse ka qenë mungesa e një aparati administrativ me personal të caktuar, gjatë këtyre tre vjetëve mund të kishim rezultata edhe më të mira në punën tonë po të që se një pjesë e anta-

reve të Komitetit Drejtonjës do të kryenin detyrat e ngarkuara me kohë dhe do ta ndjenin më mirë përgjegjësinë si antarë të komitetit drejtonjës dhe të tjerët si antarë të Lidhjes.

Diskutimet krijonjëse sidomos gjatë vitit 1954 kanë qënë shumë të paka. Nuk janë marrë në diskutim nga Lidhja kompozimet e kompozitorëve të riq si Laca, Leka, Plumbi, Rrota e të tjerve, të cilët kanë nevojë të ngrihen nga ana profesionale. Eksperiencia e punës ka treguar se diskutimet krijonjëse që janë zhvilluar u kanë vlejtur mjaft kompozitorëve, i kanë mobilizuar ata në punë dhe është parë një mobilizim iedhe më i mirë për të shkuar përparrë nga ana profesionale.

Ne mund të themi me këqardhje se konferencat e leksionet me karakter ideoprofesional nuk janë ndjekur jo vetëm nga antarët e Lidhjes por shpesh herë edhe nga anëtarët e komitetit drejtonjës. Kursi i harmonisë me gjithë që për një kohë dha rezultate të mira më vonë u la dhe nuk u ndoq. Po ashtu edhe ai i dirigimit e i formave muzikore. Kryesija e Lidhjes nuk u kujdes që të përkthente materjal teorik nga rusishtja për këtë punë. Një pjesë e anëtarëve nuk kanë kryer me kohë detyrat e ngarkuara, këtu mund të përmenden shokët Mustafa Krantja, Abdulla Grimci, Kostandin Trako e Baki Kongoli, të cilët kanë qenë të ngarkuar të diskutonin mbi veprat e kompozitorëve të ndryshëm dhe nuk e kanë bërë detyrën e tyre. Plani i diskutimeve për vitin 1954 nuk është realizuar. Në mbledhjet e komitetit drejtonjës kanë munguar shpesh shokët Besim Levonja, Mihal Ciko, Spiro Kristo, Esma Agolli, Jorgjija Truja, Gaqo Avrazi e të tjerë.

Sic konstatohet në këtë raport, në arkitekturë me përjashtim të disa pak leksioneve apo konferencave nuk është bërë asgjë tjetër. Përgjegjësi për këtë ka shoku Gani Strazimiri, i cili jo vetëm s'ka treguar interesimin më të vogël për punët që i janë ngarkuar, por ka munguar shpesh në mbledhjet e Komitetit drejtonjës.

Në vendimin që mori mbledhja plenare e Lidhjes në fund të dhjetorit 1953, si pikë e parë veshesh forcimi i punës së kryesisë dhe e Komitetit drejtonjës të Lidhjes dhe antarët e komitetit drejtonjës të kryein detyrat e ngarkuara. Gjatë vitit 1954 puna pati një rënje edhe më të madhe dhe nuk u muar asnjë masë për ata që neglizhuan. Për këtë mban përgjegjësinë në radhë të parë Kryetari i Lidhjes shoku Foto Stamo, nënkytarët Janaq Paço dhe Mustafa Krantja dhe të gjithë anëtarët e tjerë të komitetit drejtonjës.

Kontakti midis Lidhjes dhe anëtarëve të saj në qytete të tjera ka qenë i pamjaftueshëm dhe shokët anëtarë që nuk banojnë në Tiranë e kanë ndjerë vehten të shkëputur nga organizata e tyre. Nuk është praktikuar dërgimi i ekipeve të kompozitorëve në uzina, kantiere e qendra pune, janë dërguar vetëm piktorë e skulptorë edhe këta shumë pakë dhe jo kompozitorë dhe si rezultat i kësaj muzikantët tanë nuk njojin sa duhet klasën tonë puhëtore që ndërtim me heroizëm jetën e lumtur, nuk njojin bujqit tanë që janë pararojë për rendimente të larta në prodhim, nuk njojin herojt e punës, shkurt njerëzit që ndërtojnë bazat e socializmit dhe i jepin popullit kaqë e kaqë të mira. Të gjithë e dijmë se pa studiuar mirë jetën e përditëshme të popullit tonë, pa e studiuar atë në thallisë, pa njojur të renë e cila triumfon gjithëmonë në luftë me të vjetër, ne jo vetëm që do të jemi larg realizmit socialist, por do të biem edhe në gabime trashanike, duke i kënduar bujkut, stahano-vistit e njeriut të shoqërisë sonë të re me gjuhë të vjetër e cila të çon

në qorr sokak ose do të pikturojmë në pllakatë ose tabllo fëtyra njerezish që s'janë tonët.

Me gjithë që çështja e krijimit të këngëve për masa e të puni meve nga folklori ka qenë edhe mbetet problem, kjo ende nuk ka gjetë zgjidhen e duhur, qoftë nga kryesija, qoftë nga komiteti drejtonjës dhe bashkëpunimi me shkrimtarët len ende për të dëshiruar.

Nuk është përfituar sa duhet nga eksperiencia e artit sovjetik. Material e përkthyera kanë qenë të pakta e të pamjaftueshme. Shumë pakë është shkruar në organin tonë «Nëndori» mbi çështjet që kanë të bëjnë me krijimtarinë. Kryesija e Lidhjes dhe komiteti drejtonjës me gjithë që e kanë patur si problem këtë çështje nuk kanë luftuar sa duhet në mënyrë që revista «Nëndori» të ishte me të vërtetë një tribunë, ku të rriheshin probleme të ndryshme që i përkasin krijimtarisë artistike në vendin tonë. Është shkruar shumë pak për pikturën dhe asgjë mbi arkitekturën dhe sidomos mbi artin tonë popullor, mbi kostumet, ornamentet, shkurt mbi pasurinë e artit tonë popullor, jo vetëm në artet figurative por edhe në muzikë. Kritika në shtyp deri tanë nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Ajo në disa raste ka qenë subjektive. Fakti që ne kemi një organ tonin duhet që të na mobilizojë që t'u vimë në ndihmë kompozitorëve, piktorëve e skulptorëve jo vetëm me reçensione të thjeshta por me studime të mira e shkencore, me një kritikë të drejtë e objektive.

Komisioni i ngarkuar nga komiteti drejtonjës i ka bërë disa ndryshime statutit të Lidhjes, të cilat konsistonjë në perforsimin e saj dhe në percaktimin e pjesëmarrësve si antarë në organizatën tonë. Me këto ndryshime siç do ta shihni do të forchet edhe më tepër organizata jonë dhe ne kemi besim se në të ardhmen nën udhëheqjen e Partisë e me ndihmën e çmuarshme të eksperiencës së ndritur të artit sovjetik, do t'i ia dalim në krye për të përmblushë me nder detyrat që na ngarkon populli dhe Partija.

Organizimi i ri do të forcojë edhe më tepër lidhjen tonë dhe komiteti i ri drejtonjës si edhe gjithë organizata e jonë në të ardhmen do të kenë si detyrë të parë përforsimin e punës për të ruajtur me besnikëri pastërtinë e drejtimit ideologjik t'arteve duke luftuar të gjitha pikpamjet e huaja në artet tona, të luftojë me vendosmëri çfaqjet kozmopolite, përcëmimin për krijimet e artistëve tonë, përuljen karshi artit dekadent borgjez dhe konsideratën për krijimet e profesionistëve tunë.

Lidhja e artistëve do të luftojë me ngulm në t'ardhmen në mënyrë që kompozitorët, piktorët, arkitektët e skulptorët tonë të njojin dhe të paraqesin mirë punonjësit e vendit, klasën puntore, fshatarësinë tonë punonjëse, të njojin së afërmi dëshirën dhe aspiratat e popullit, të jetojnë bashkë me të. Për këtë t'u krijojë artistëve tonë kondita të shkojnë në kooperativa, uzina, kantiere, fabrika, që të njojin së afërmi jetën tonë të re.

Një nga detyrat e rëndësishme të Lidhjes në të ardhmen do të jetë kujdesi për të rritur talente të reja, për t'i venë organizatës gjak të ri. Kjo do të kryhet me organizimin e diskutimeve krijonjëse, organizim kursesh e seminarësh, me praktikim patronazhesh e të tjera.

Për të plotësuar me nder këto detyra do të merren këto masa:

1) Të funksionojë me regull Lidhja nga ana organizative, duke kryer seicili detyrën e ngarkuar, qoftë antar i thjeshtë apo i zgjedhur në forum duke respektuar me rigorositetin më të madh statutin.

2) Komiteti drejtonjës të bëjë mbledhje të regullta për të shtruar probleme të rëndësishme që i përkasin zhvillimit të mëtejshëm të artit në vendin tonë duke i ngarkuar me përgjegjësi antarët e tij.

3) Të zhvillojë gjerësisht e me plan të caktuar diskutimet krijonjëse si i vetmi mjet që i çon përpara antarët e Lidhjes në punën e tyre krijonjëse.

4) Të organizojë kurse e seminare me të rinjtë dhe konferanca të ndryshme me karakter ideologjik e profesional.

5) T'i kushtojë një kujdes të veçantë revistës «Nëndori» duke botuar artikuj të ndryshëm e buletine aksesore të revistës ku të ketë materiale sovjetike dhe studime të gjera të njerëzve tonë, të cilat për mungesë vendi nuk mund të botohen në revistë por me buletin aneks.

6) Të popullarizojë krijimtarinë e artit tonë të ri, zhvillimin e përparimin e tij, prodhimet e piktorëve, skulptorëve dhe kompozitorëve tonë. Të organizojë çdo vit ekspozita, jo vetëm në kryeqytet, por edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. Të praktikohen ekspozita të një piktori a po skulptori, të një grapi të veçuar dhe ekspozita nacionale që të qarkullojnë në gjithë territorin e Republikës.

Plenumi i Lidhjes së Artistëve

Më 25 dhe 26 shkurt të k. v., në një nga sallat e Shoqërisë së miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik, në Tiranë, u bë mbledhja plenare e Lidhjes së Artistëve të Shqipërisë, e cila shqyrtoi punën e kryer nga Lidhja qysh nga krijimi i saj e gjer më sot. Në mbledhje merrnin pjesë kompozitorë, piktorë, skulptorë, arkitektë e mjaft të ftuar të tjerë. Ndodheshin gjithash tu sekretarja e Komitetit Qëndror të Partisë shoqja Liri Belishova, zv. kryetar i Këshillit të Ministrave shoku Manush Myftiu dhe Ministri i Arësimit dhe Kulturës shoku Bedri Spahiu.

Ditën e parë të plenimit, më 25 shkurt, shoku Foto Stamo, president i Lidhjes, referoi mbi zhvillimin e arteve figurative.

Mbledhja plenare e 25 shkurtit mbi krijimtarinë në artet figurative tregoi se piktorët e skulptorët tanë janë hedhur me guxim në forma të zgjeruara siç është kompozicioni, tablloja, grupet skulpturale etj. Ajo tregoi se krahas me punën e bërë piktorët e skulptorët shqiptarë të ndihmuar nga eksperiencia e artit sovjetik, jo vetëm që kan shkuar përparrë nga ana profesionale, por kanë mundur gjithashtu të zbatojnë me sukses metodën e realizmit socialist në art, kanë studjuar me zell ligjet e estetikës markiste-leniniste sipas të cilave arti nuk tregon vetëm të bukurën por para së gjithash të vërtetën.

Por si në referatin e sh. Foto Stamo ashtu edhe në diskutimet dualën një serë të metash e dobësish të cilat pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të arteve figurative dhe që venë para piktorëve e skulptorëve detyra të rëndësishme të cilat konsistonë së pari në njohjen thellë të realitetit të jetës sonë dhe në përvetësimin e

teknikës së ndërtimit të planeve të personazheve në një kompozicion dhe në përvetësimin e mirë të vizatimit. Pa një vizatim të mirë dhe një ndërtim të mirë të figurave dhe objekteve, edhe elementet e tjerë si ngjyrat, dritat, hijet etj. humbasin vlerën e tyre. Njohja e terrenit, e realitetit të jetës sonë qëndron në studimin realist e psikologjik të natyrës sonë, të njeriut tonë të ri që ndërton me heroizëm bazat e socializmit. Në diskutimet e zhvilluara në mbledhjen plenare për krijimtarinë e arteve figurative u kritikua me të drejtë se në shumë pllakata e tabllo fytyrat e njerëzve s'janë shqiptare. Në diskutimin e tij sh. Nexhemidin Zajmi, si vuri në dukje disa të meta në punimet e disa piktorëve dhe skulptorëve, tha se piktori dhe skulptori duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me njerëzit, me natyrën, dhe nuk duhet vepruar kurrë mbas fantazisë e cila të çon shpesh herë në gabime të pajustifikueshme. Natyra e gjallë, — tha ai, — është për piktorin dhe skulptorin mjeti kryesor, nga ku ushqehet, frysëzohet dhe pasqyron të vërtetën.

Një çështje e rëndësishme që u ngrit si në muzikë ashtu edhe në artet figurative është njohja e traditave të popullit tonë, të piktorëve e të skulptorëvet tanë të vjetër, sepse vetëm tani nën kujdesin atnor të Partisë e Qeverisë po studjohen e po dalin në shesh vlerat artistike të së kaluarës. Shumë piktorë e skulptorë shqiptarë kanë krijuar vepra që ende nuk nijhen nga artistët tanë. Veprat e piktorit Elbasanas Onufri të shekullit të XVI, afresket e pikurat e tjera që gjemjë në Voskopojë e në vende të tjera tregojnë se ne kemi tradita. Shumë piktorë e skulptorë shqiptarë kanë rrë

lavdi dhe jasht atdheut. Artizantë shqiptar ka nxjerrë mjeshtër të mbaruar. Këtë e dëshmojnë shumë zbulurime e ornamente të ndryshme që i gjemjë edhe sot në ditët tona. Çështjes së traditave tonia ia kushtoi diskutimin e tij shoku **Ramadan Sokoli**.

Çështjes së vizatimit në shkolla e në liceun artistik «Jordan Misja» diskutonjësi **A. Buza** i bëri një analizë të drejtë. Si theksoi rëndësinë e vizatimit, ay propozoi mënyra konkrete për vizatimin në shkolla si përpilimin e një libri vizatimi për shkolla, formimin e një ambjenti me të vërtetë artistik për nxënësit në lice, praktikimin e shetitjeve dhe rëndësinë që kanë mjetet figurative për spjegimin e lëndëve të tjera si historisë, gjeografisë, shkencave etj. Ay theksoi se në shumë shkolla të Tiranës e të qyteteve të tjera mësimit të vizatimit nuk i epet rëndësia e duhur.

Si në referat ashtu edhe në diskutimet u ngrit çështja e konfliktit në pikturë e skulpturë, e cila nuk është zgjidhur akoma. Për të paraqitur sa më reale luftën e përpjekjet e popullit tonë është nevoja që në të ardhmen piktorët e skulptorët të paraqesin jetën, të renë që lind e rritet gjithmonë në luftë me të vjetrën.

Më 26 shkurt u zhvillua mbledhja plenare mbi krijimtarinë muzikore. Si në raportin e paraqitur nga **Dhora Leka** ashtu edhe në diskutimet e pjesëmarrësve u ngriten shumë çështje me rëndësi të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e më tejshëm të artit muzikor në Shqipëri.

Përdorimi i një gjuhe muzikore origjinale e cila të mbështetet në motivet ritmike e melodike të folklorit e që shpreh me vërtetësi ndjenjat e aspiratat e popullit ka qenë një nga çështjet kryesore që u diskutuan. Shumë kompozime

të gjinive e formave të ndryshme ende nuk kanë ngjyrën nationale. Përdoret në shumë raste gjuhë e ftohet dhe abstrakte që mund të thuhet dhe e vjetër po të marrësh parasyshë temën që trajton. Kjo vjen nga që kompozitorët tonë jo vetëm që shpesh s'janë në kontakt të ngushtë me popullin, por kanë mënjanuar si të thuash studimin e folklorit të këngëve dhe të valleve popullore. Në raport dhe në diskutimet u shtrua me forcë çështja e këngëve të masave, të cilat kohët e fundit nuk kanë qenë në lartësinë e duhur e nuk u janë përgjegjur nevojave gjithnjë më të mbëdha të masave tonë punonjëse.

Një çështje tjetër me rëndësi që u ngrit me forcë që përpjekja që duhet të bëjnë kompozitorët tanë pér ngritjen e tyre ideologjike e profesionale. Gjatë këtyre dy a tre vjetëve të fundit shihet një përparim i dukshëm në krijimtarinë e gjinive muzikore me formë të zgjeruar siç është kantata, tablloja, oratori, opereta etj. Kjo është një anë pozitive. Por në to shihen dobësi që i përkasin formës e ndërtimit të tyre. Në shumë pjesë të kompozitorëve Kono, Trako, Jakova, Uçi etj. ka të dhëna për muzikë skenike, por gjuha muzikore e personazheve ka të meta, ndërtimi skenik, aksioni, konflikti, dramaturgji etj. lenë pér të déshiruar. Kjo vjen më tepër nga që kompozitorët nuk janë thelluar shumë në studimin e formave muzikore, në polifoninë, kontrapuntin, orkestracionin e së gjithash mbi ligjet e ndërtimit skenik.

Shumë kompozitorë ngriten në diskutimet e tyre bashkëpunimin e ngushtë me shkrimitarët. Çështja e studimit të ligjeve të teatrit, të aksionit skenik, shkurt të ndërtimit të një libreti që trajton një temë të caktuar paraqitet si nevojë e domosdoshme jo vetëm pér kom-

pozitorët, por në radhë të parë për shkrimtarët. Një libret i mirë është gjysma e punës. Çështja e bashkëpunimit u ngrit si nevojë urgjente nga të dy palët jo vetëm përsa i përket muzikës skenike, por edhe këngëve për masa.

Shoku Sofokli Paparisto ngriti në diskutimin e tij çështjen e edukimit muzikal të fëmijëve, e cila ende nuk ka gjetur zgjidhjen e duhur. Me gjithë që kohët e fundit kompozitorët tanë i kanë kushtuar një kujdes të veçantë krijuar të këngëve për fëmijë këto ende nuk shumë fishohen e shpërndahen në Republikë. Ai foli edhe mbi rëndësinë që ka përhapja e literaturës muzikore të fëmijve me anë të radios. Kritikoi Ministrinë e Arësimit dhe Kulturës dhe Radio-Difuzionin për kujdesin e pakë që kanë treguar në përhapjen e këngëve për fëmijë. Ay propozoi që Radio-Tirana të bëjë inçizime nga grupe korale pionierësh në kryeqytet e në qytete të tjera dhe tregoi shembulla praktike për kompozime të kësaj gjinije dhe për edukimin e masave të fëmijve dhe pionierve.

Shoku Gaqo Avrazi në diskutimin e tij ngriti çështjen e kontaktit të kompozitorëve me popullin. Shumë pak është praktikuar nga Lidhja e Artistëve dërgimi i ekipeve të kompozitorëve në qendra pune, kooperativa bujqësore, uzina, kantjere etj. Mungesa e kontaktit e artistëve tanë me jetën e popullit, — tha ai, — bën që ata të mos e njohin realitetin, të mos i këndojnë sa duhet vrullit revolucionar të masave punonjëse, të mos i këndojnë sa duhet fshatarit që sot është zot i tokës e nxjerr rendimente të larta, punitorit të uzinës apo kantjerit i cili prodhon kaqë e kaqë të mira.

Muzika e jonë shumë pak popullarizohet jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë, — tha në disku-

timin e tij sh. Petro Kito, Drejtë i Radio-Difuzionit të Shtetit. Ay tha se Radio Tirana ka shumë pak këngë partizane dhe se shumë këngë nuk inçizohen. Ay kritikoi më të drejtë Filarmoninë Shqiptare • cila nuk është interesuar që të inçizoj pjesët e preatitura të kompozitorëve shqiptarë dhe se në Filarmoni ka tendencia që të vihen në repertor më tepër pjesë të huaja se sa të kompozitorëve shqiptarë. Ay tha se Ansambli artistik i ushtrisë i ka shërbypet shumë Radios sonë me inçizimet që ka bërë. Sh. Petro Kito propozoi për ngritjen dhe organizimin e një kabineti folklori i cili të mbledhë e të regjistrojë meloditë e këngëve e të valleve tona.

Reth muzikës popullore dhe studimit të saj foli kompozitori Ramadan Sokoli i cili theksoi se përtia arritur një forme e stili nacional në kompozimet tona ne duhet të bazohemi në folklorin e pasur të popullit tonë duke studjuar vazhdimisht polifoninë popullore dhe nga ajo të nxjerrim ligjet e regullat. Pasi përmendi ndihmën që kanë dhënë në këtë drejtim festivalet, ai e shtroi si çështje të rëndësishme ngritjen e një sektori të folklorit pranë Lidhjes s'Artistave, — foli për kritikën që ka qenë e pakët dhe në fund tha se populli njihet ende pak me veprat tona. Në fund ay foli për traditat e popullit tonë në artin muzikor.

Kompozitori Muharrem Xhediku pranoi kritikën që i bëhej në rapportin e sh. Dhora Leka për një rrugë të gabuar në disa krijime të tij të fundit dhe premtoi se në të ardhmen do të punojë me zell duke përdorë një stil nacional në kompozimet e tij. Ai propozoi krijimin e një biblioteke muzikore dhe organizimin e kurseve dhe të seminareve për kompozitorët e rinj.

Shkrimtari Kolë Jakova ngriti në diskutimin e tij studimin e la-vrimin e muzikës popullore të Shqipërisë së mesme, e cila paraqet një terren interesant për kompozitorët, pranoi kritikat që iu bënnë për dobësitë e të metat e libretit të operës «Agimi» dhe foli për traditat e popullit shqiptar në të kaluarën në sektorin e muzikës.

Shkrimtari Lazar Siliqi ngriti çështjen e bashkëpunimit të ngushëtë ndërmjet shkrimtarëve dhe kompozitorëve, popullarizimin e muzikës me anë botimesh të veçanta dhe krijimin e këngëve lirike për rininë. Ai ftoi gjithë artistët që të marrin pjesë aktive në diskutimin e problemeve të artit dhe në vlerësimin e veprave artistike në faqet e revistës «Nëndori».

Studentja e Institutit të lartë Pedagogjik Peri Gjata ngriti çështjen e edukimit të rinisë me kulturën muzikale, foli mbi konferencat, komentet që mund të bëhen në shtyp dhe në Radio.

Kompozitori Pjetër Dungu ngriti çështjen e repertorit për bandat e fanfarat dhe çështjen e harmonizimeve për bandë. Ai kritikoi me të drejtë orkestrinat e lokaleve, të cilat luajnë pjesë të papërshtatësimeve.

Kompozitori A. Grimci foli mbi nevojën e muzikës së vallzimit e cila dëri tani ka munguar dhe solli si shembull punën që bëhet në B.S. e Demokracitë popullore përkëtë gjini.

Kompozitorët Trako, Kongoli e Uçi folën mbi nevojën e bashkëpunimit midis shkrimtarëve dhe kompozitorëve në lidhje me librettet, mbi nevojën e njohjes së ndërtimit skenik të muzikës operistike e të ndërtimit në përgjithsi të formave muzikore të një gjinije të lartë.

Më 26 shkurt, pasdreke, të pranishmit dëgjuan raportin mbi vëprimtarinë e Lidhjes që nga kriimi i saj e gjer më sot. Raportin e mbajti shoku Baki Kongoli. Pas raportit të shokut Baki u bënë diskutime. Pastaj kompozitori Kostandin Trako i propozoi mbledhjes për disa ndryshime në statutin e Lidhjes, të cilat u aprovuan.

Mbledhja zgjodhi Komitetin e ri drejttonjës të Lidhjes prej 13. vëtësh:

Gaqo Avrazi
Besim Daja
Eqrem Dobi
Prenkë Jakova
Kristo Kono
Balki Kongoli
Anton Kuqali
Dhora Leka
Andrea Mano
Janaq Paço
Foto Stamo
Kostandin Trako
Nexhmedin Zajmi

Komiteti Drejttonjës zgjodhi për president të Lidhjes shokun Foto Stamo dhe sekretar të Lidhjes shoqen Dhora Leka.

Gjatë 10 vjetve të pushtetit popullor, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, si në të gjithë sektorët e ekonomisë e të kulturës ashtu edhe në artet figurative e në muzikë janë korrë suksese të mira, që hapin perspektiva për një zhvillim më të hovishëm të artit tonë në përgjithësi. Mbledhjet që u zhvilluan më 25-26 të shkurtit treguan jo vetëm sukseset që kanë korrë punonjësit tanë të artit në pikture, skulpturë dhe muzikë, por nga raportet dhe diskutimet e mbajtura duallën një tok detyrash, të cilat përcaktojnë zhvillimin e drejtë në këto sektorë të rëndësishëm të artit tonë të ri.

Plenumi i Lidhjes së artistëve të Shqipërisë tregoi interesimin gjithënjë më të madh të piktorë-

ve, skulptorëve, kompozitorëve, të të gjithë artistëve tanë, për problemet që i dalin artit në rrugën e zhvillimit të tij, për njojjen sa më thellë të jetës sonë, për një jetë më të organizuar të Lidhjes së Artistëve. Por plenumi tregoi gjithashutu edhe pëngatitjen ende të pamjaftueshme të artistëve tanë në fushën ideo-artistike, tregoi se ata bëjnë përpjekje të pakta për njojjen e realitetit, se Lidhja e Artistëve nukë ka arritur ende të bëhet një qendër e gjallë, ku, në frymën e kritikës e të autokritikës, të rrihen problemet artistike, të vlerësohen drejt veprat artistike dhe të krijohet një bashkëpunim i vërtetë shoqëror në mes të artistëve. Edhe vetë organizimi dhe zhvillimi i plenumit provon punën ende të dobët të Lidhjes së Artistëve. Ndërsa nga të pranishmit raporti për muzikën mbajtur nga shoqja Dhora Leka u gjet mjaft i mirë dhe objektiv, raporti mbi aritet figurative mbajtur nga Foto

Stamo ish i zgjatur dhe me material të pasistemuar shumë qartë. Nga ana tjetër, Komiteti Drejtonjës i Lidhjes së Artistëve nuk kish bërë një punë të organizuar që shokët artistë të vinin sa më të përgatitur në plenum, duke ngritur çështje parimore dhe duke analizuar veprat konkretisht. Disa diskutime, sidomos në mbledhjen kushtuar arteve figurative, qenë tepër personale dhe tregonin se në gjirin e artistëve nuk janë çdukur ende mbeturinat e mëndjemadhësisë, cmirës, tarafit.

Diskutimi i problemeve të krijuar e muzikore e të arteve figurative në mbledhjen plenare të Lidhjes së Artistëve, analiza e të metave në punën e artistëve dhe në punën e Lidhjes, u shtrojnë detyra të rëndësishme artistëve tanë, Komitetit të ri Drejtonjës, që të zhvillojnë një punë më të madhe e të organizuar për lulëzimin e artit në vëndin tonë.

Mbledhja e Këshillit të Përgjithëshëm Arësimor të Ministrisë s'Arësimit e Kulturës mbi mësimin e gjuhës në shkollat tona

Me 10 shkurt të k.v. u mblodh Këshilli i Përgjithëshëm Arësimor i Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës dhe shqyrtoi problemin e mësimit të gjuhës në shkollat filllore, shtatëvjeçare edhe të mesme.

Referatin kryesor e mbajti ministri i arësimit dhe i kulturës shoku **Bedri Spahiu**.

Shoku Bedri Spahiu vuri në dukje sukseset e mëdha, që ka pasur shkolla jonë e re dhe në mësimin e gjuhës, sidomos pas reformës së madhe arsimore të vitit 1946: - Shkollat tona - të çdo kategorije - janë paisur në mësimin e gjuhës me tekste, që s'i kanë pasur kurrë; janë paisur me programe të hartuara në bazë të eksperiençës së shkollës Sovjetike, programe të xhveshura fare nga elementet antishkencore dhe që përmbytjanë ç'ka ka më të bukur letërsija jonë, që prej kohës së Buzukut gjer në ditët tona, ç'ka ka më të bukur letërsia e përbotëshme gjer në letërsinë pararojë sot, letërsinë sovjetike; janë të paisura me ç'ka ka më të bukur krijimtaria popullore.

Shoku Bedri Spahiu midis të tjera tha:

«Në planet mësimore të shkolave tona mësimi i gjuhës e i letërsisë zë një vend të mirë. Sot gjithë kategoritë e shkollave të arsimit të përgjithshëm janë të pajisura plotësisht me tekste të gjuhës dhe letërsisë, gjë që nuk ka qenë e mundur të arrihet asnjëherë në të kaluarën. Programet dhe tekstet e sotme për gjuhën dhe letërsinë, si dhe gjithë programet e tjerë, me gjithë të metat që mund të kenë, qëndrojnë në një nivel shumë më të ngritur shkencor se sa ato të shkollës së vje-

ter».

«Studimi i folklorës sonë, i teorisë së letërsisë, i kursit të letërsisë sonë të vjetër, arbreshe dhe të re, kryhet nëpërmjet tekstesh të posaçme, mjaft të pasura nga përbajtja. Ndarja e mësimit të gjuhës prej atij të letërsisë në shkollën 7-vjeçare e në atë të mesme, e shton edhe më shumë rëndësinë shkencore dhe pedagogjike të këtyre mësimeve. Kështu programet e tekstet e gjuhës e të letërsisë në shkollën tonë u jepin nxënësve më shumë njojuri shkencore mbi këto lëndë. Nëpërmjet librave të këndimit dhe t'antologjive, nxënësit njojin trashëgimin më të bukur që kemi ne nga letërsia jonë artistike dhe nga folklora, si dhe pjesë nga veprat më të dëgjuara të letërsisë botërore, që nga kohët më të vjetra. Përmes copave të këndimeve e t'antologjive, nxënësit pregatiten për kuptimin materialist të natyrës e të shoqërisë dhe njojin përpjekjet e popullit tonë për liri. Me anën e tyre, nxënësit kuptojnë edhe më mirë rëndësinë e revolucionit popullor, epopenë e Luftës nacional-clirimtare, përpjekjet për ndërtimin e bazave të socialistëve që mësuarinë e madhe me Bashkimin Sovjetik, me vendet e demokracisë popullore dhe me gjithë popujt lidhës së botës. Atyre u ngjallat dhe u rritet dashuria për popullin, për partinë, për Bashkimin Sovjetik, për bulkuritë e pasuritë e natyrës isë vendit tonë, për gjuhën shqipe. Parashtimi sistematik i gjithë këtyre pasurive dhe njojurive gjuhësore e letrare jo vetëm zgjeront horizontin e nxënësve, por edhe i edukon ata me frymën e moralit komunist.»